



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQERIA RAJONALE UJESJELLES KANALIZIME SHKODER SH.A

Date 21.09.2026

PROCES VERBAL - Tipi i kontratës – PUNË
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky proces verbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: NDERTIMI I RRJETIT TE UJESJELLSIT PER ZONEN E SHIROKES. BASHKIA SHKODER.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj; 18 Muaj

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- (CPV): 45247130-0 - Punime ndërtimi për ujësjellës

VLERA E FONDIT LIMIT: 342,972,985 (treqind e dyzet e dy milion e nentëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e nentëqind e tetëdhjetë e pesë) lek pa tvsh

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga **Buxheti i Shtetit**.

Autoriteti kontraktor në kriteret e përgjedhjes së fituesit ka përgjedhur si më poshtë:

A) Oferta ekonomike më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

Çmimi ☐	pikët 50
Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit ☐	pikët 20
Stafi / Organizimi i Kompanise ☐	pikët 15
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social ☐	pikët 10
Periudha e garancisë së objektit ☐	pikët 5

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Metodologjia e vlerësimit për Ofertën ekonomike më të favorshme bazuar në kosto

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100. Autoriteti kontraktor do të vlerësojë pikët për kriteret me vlerësim relativ (kriteri 1, 2.a, 5) e rumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore (0,00) ndërsa për kriteret me vlerësim absolut (kriteri 2.b , 3, 4) do të vlerësohen me numra të plotë (0).

Kriteri:

1. Çmimi [50] pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k1}$ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k1}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

2. Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit [20 pikë]

Operatori ekonomik mund të propozojë duke paraqitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori duhet të argumentojë (në mënyrë përshkimore dhe grafike) kohën e propozuar (**jo më shumë se 18 muaj**). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nënkriteri:

a. Koha e realizimit të punimeve të kontratës që përfshin: [15 pikë]

I Kohën e mobilizimit në kantier (jo me shume se 3 muaj) [2 pike].

II Grafiku i punimeve te Kontratës. [13 Pike]

*Shënim: Operatori ekonomik për të justifikuar propozimin e këtij nënkriteri duhet të paraqesë minimalisht analizen e makinerive që do angazhojë operatori ekonomik për secilin proces dhe numrin e përafërt të punonjësve të angazhuar për çdo proces.

Pikët për këtë nën-kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k2a} = V_{\min k2a} \times P_{\max k2a} / O_{k2a}$$

P_{k2a} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k2a}$ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k2a}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k2a} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

- b. Faktorë favorizues / pajisje inovative / metodologji punimesh që favorizojnë kohën e realizimit të punimeve [0-5 pikë]

3. Staf / Organizimi i kompanisë [15 pikë]

Operatori ekonomik duhet të tregojë se do të angazhojë në kontratë staf me eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit. Për të treguar këtë fakt operatori duhet të depozitojë për secilin nga stafi kryesor dokumentacionin e kërkuar në seksionin 2.3 / Kriteret e veçanta të kualifikimit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencia në fushen specifike [13 pikë]

***Shënim:** Vlerësimi i këtij nenkriteri do të realizohet sipas percaktimeve me poshte:

I. Dëshmi që stafi plotëson vetëm kushtet e kritereve të vecanta të kualifikimit për stafin [1 pikë]

II. Dëshmi që stafi disponon kualifikime akademike mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e vecanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]

III. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në vite pune mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e vecanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]

IV. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në natyrë/kompleksitet të ngjashme me kontratën e prokurimit. [6 pikë]

Për përmbushjen e kritereve të mësipërme duhet të dorëzohet CV dhe dëshmi/reference/dokumentacion të leshuar nga punëdhënësi të mëparshëm ose përfituesit.

- b. Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi [0 - 2 pikë]

***Shënim:** Për përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori ekonomik duhet të dorëzojë organigramën e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologji të nderveprimit midis strukturave me njëra-tjetrën, me mbikëqyresin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor/Entin. Avantazh përbejnë sistemet e brendshme të kontrollit dhe menaxhimit të cilësive.

4. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [0-10 pikë]

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS)). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / eficientë / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor.

Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. [0-5 pikë]

- b. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve. [0-5 pikë]

5. Periudha e garancisë së objektit [0 – 5 pikë]

Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshtatës:

Periudha e garancisë e punimeve civile / pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0 - 5 pikë]

Pikët për këtë nën-kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = V_{\min k5} \times P_{\max k5} / O_{k5}$$

P_{k5} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k5}$ Vlera e më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k5}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k5} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Argumentim:

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në barzë çmimit ose kotos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilesi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës procedurë prokurimi, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

Kritere të tilla mund të përfshihen:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë. projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij;

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose

c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet dorëzimit, si, për shembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit, Elementi i kostos, gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë.

3. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve, ose

b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë substancës së tyre thelbësore.

5, Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i i, çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të raste kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

Njësia e Prokurimit hartoj kërkesën për Grafikun e punimeve dhe kohën e mobilizimit dhe ka kërkuar këte kriter 20 pikë, duke vlerësuar rëndësinë që ka ky element në përfundimin e plotë dhe realizimin sukses të cdo vepre, pasi duke ndërthurur elementin cilësi, saktësi dhe precizion në kryerjen e punimeve por edhe angazhimin realisht të të gjithë stafit, inxhinierë, teknikë, specialistë, punëtorë të thjeshtë etj, mund të arrihet që punimet të kryhen edhe më shpejt se koha e planifikuar nga autoriteti kontraktor dhe njëherësh me cilësinë e duhur, duke i dhënë besimin këtij autoriteti për angazhimin serioz dhe të operatorit ekonomik pjesëmarrës cili në përfundim do të siellë rezultatet e kërkuara dhe të pritura nga autoriteti.

Operatori Ekonomik mund të propozojë duke paragitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori Ekonomik ofertues duhet të argumentoj në mënyrë përshkimore kohën e propozuar të kryerjes së punimeve.

Po kështu një rëndësi e vecantë nga autoriteti kontraktor i jepet edhe elementit Stafi/ Organizimi Kompanise, i cili vlerësohet deri në 15 pike, duke ditur që vetm një staf kualifikuar profesional inxhiniero - teknik dhe me pervoiën e duhur mund të sielle rezultatet e dëshiruara dhe të pritura nga autoriteti, kontraktor për përfundimin me sukses të objektit të prokurimit. Një operator ekonomik cili ka një staf të tillë mund të konkurrojë me cilesi pranë autoritetit kontraktor dhe të përmbushë të gjithë detyrat e projekt preventivit të parashikuar nga autoriteti kontraktor. Operatori Ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se do të angazhojë në kontratë një staf me përvojë eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit.

Disa nga nënkriteret janë formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencia në fushën specifike të cili provohet me dokumentacionin përkatës Gjithashtu operatori ekonomik duhet të paragesë edhe skemën e organizimit të stafit të propozuar për realizimin e kontrates, organigramen e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologjinë e ndërveprimit midis strukturave me njëra- tjetrën, me mbikqyrësin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor etj.

Në lidhje me Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, autoriteti kontraktor ka kërkuar deri në 10 pikë, duke ditur rëndësinë që ka mjedisi aktualisht dhe fakti që ne me veprimet apo mosveprimet tona ndikojnë në mjedis dhe në komunitetin tonë të përbashkët pozitivisht/ negativisht

Duke patur parasysh se përvec realizimit të veprës duhet që të aplikohet nga operatorët realizues të punimeve edhe parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi i ndikimeve negative ndaj mjedisit. Duke ditur që nga punimet që do të kryhen gjatë ndërtimit të një vepre mund të krijohen mbetje inerte, detyrat kryesore që do të ketë parasysh operatori ekonomik janë ndër të tjera edhe kontrolli i vazhdueshëm i gjendjes së mjedisit në territorin ku do të zhvillohet aktiviteti, mbajtja pastër e gjithë territorit ku kryhet veprimtaria, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në mjedis, flore dhe faune, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në popullsi, shëndetin human, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në klimë, ajër, ujë, tokë etj. Në veçanti duhet të kushtojë rëndësi edhe faktorëve: Respektimi i procedurave, normave, standarteve dhe planifikimet e paragitura në projekt gjatë realizimit të tij si dhe të kontrollojnë vazhdimisht ecurinë e treguesve mjedisorë.

Për të gjitha këto elementë operatori ekonomik pjesëmarrës bën një pasqyrë të qartë dhe të detajuar që në momentin kur ai konkuron në procedurën e prokurimit duke dhënë Propozime konkrete se si do të ndikojë në uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, dhe më pas autoriteti kontraktor bën vlerësimin real me pikëzim të cdo operatori ekonomik ofertues.

Nënkriteret për operatoret ekonomike pjesëmarrës në këtë rast dhe që do të vlerësohen në mënyrë të pikëzuar nga Komisioni Vlerësimit të Ofertave të Autoritetit Kontraktor, do të jenë:

Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (migësore me miedisin të ricikluara/ eficiente/materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike, Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore Propozime konkrete për përmirësim të ekonomisë lokale të zones ku zhvillohet projekti si një iniciativë sociale e ofertuesit nëpërmjet punësimeve.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 8 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024).

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, duke qënë se afatet më të gjata detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi për mos të qenë i detyruar t'i zëvendësojë apo riparojë punimet që do të kryejë. Referuar në nenin 45 të VKM Nr. 285/2021 (i ndryshuar), kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit. Kontraktori do të garantojë cilësinë e punimeve minimalisht për 2 vjet. Çdo ofertë e paraqitur, e cila nuk përmend afatin e përcaktuar, do të vlerësohet minimalisht për një periudhë 2 (dy) vjeçare. Çdo ofertues, i cili do të paraqesë një periudhë garancie punimesh, për më shumë se 2 vjet do të vlerësohet me formulën e paraqitur në nënkriteret e mësipërme.

Një rëndësi e vecantë i është dhënë edhe Periudhës së garancisë së objektit e cila tregon jetegjatësinë e objektit, faktin se sa me maksimale të jetë periudha aë përfshin garancina e veprës e deklaruar nga operatori ekonomik pjesëmarrës, aq me tepër autoriteti kontraktor bindet për angazhimin, seriozitetin dhe kapacitetin e këtij operatori ekonomik, me qëllimin final realizimin përfundimtar të veprës dhe marrjen në dorëzim të saj.

Autoriteti Kontraktor ndalon mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera si më poshtë:

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

X

Jo

☐

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja:

- Kapaciteti ekonomik dhe financiar Kriteret e veçanta të kualifikimit, Pika 2.2.1, 2.2.2, 2.2.3, Shtojca 7 e DST-së.
- Përvoja e suksesshme në kontrata të mëparshme, kërkuar sipas pikës 2.3.1 të Kapacitetit teknik të Kriterëve të veçanta të Kualifikimit , të shtojcës 7 e DST-së;
- Licenca e kërkuara sipas pikës 2.3.2/a, 2.3.2 b) , 2.3.2 c), d) të kapacitetit Teknik të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimitm Shtojca 7 e DST-së.

- Stafi Teknik i kërkuar sipas pikës 2.3.3/a, 2.3.3/b, 2.3.3/c, 2.3.3/d, 2.3.4 të Kapacitetit Teknik të Kritereve të veçanta të Kualifikimit, Shtojca 7 e DST-se.

Argumentimi ligjor: Në mbështetje të Nenit 84, pikat 6 dhe 7 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); Nenit 90, pikat 5 dhe 6 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar).

Autoriteti kontraktor ka vlerësuar se kapacitetet teknike dhe profesionale që lidhen drejtpërdrejt me realizimin e punimeve kryesore nuk mund të transferohen tërësisht tek subjekte të treta, pasi kjo do të cenonte qëllimin e verifikimit të aftësisë reale të operatorit ekonomik që paraqet ofertën.

Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera është lejuar vetëm në masën që këto subjekte të marrin përsipër realisht realizimin e pjesës përkatëse të punimeve dhe të disponojnë licencat, personelin, pajisjet dhe eksperiencën që lidhet me zërat konkretë të preventivit që do të ekzekutojnë. Për këtë arsye është kërkuar që secili subjekt mbështetës ose anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë të disponojë licencat përkatëse në raport me punimet që merr përsipër sipas kontratës së bashkëpunimit dhe ndarjes së punimeve.

Ky kufizim mbështetet në faktin se:

- Licencat e ndërtimit përbëjnë autorizime profesionale të lidhura me aftësinë konkrete të subjektit për të realizuar kategori të caktuara punimesh dhe nuk mund të përdoren formalisht nga një operator që nuk disponon kapacitetet minimale për ekzekutimin e kontratës.
- Drejtuesit teknikë, stafi inxhinierik dhe specialistët e kërkuar janë të lidhur drejtpërdrejt me realizimin e punimeve të objektit dhe me mbikëqyrjen teknike të tyre gjatë gjithë periudhës së zbatimit. - Pajisjet dhe materialet teknologjike të kërkuara në projekt kërkojnë njohuri të specializuara instalimi dhe përgjegjësi profesionale që nuk mund të garantohen nëse operatori ofertues nuk disponon vetë kapacitetet bazë teknike për realizimin e kontratës.

Për rrjedhojë, kufizimi i mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të tjera është vendosur për të garantuar që operatori ekonomik ofertues të zotërojë vetë kapacitetet kryesore dhe thelbësore për realizimin e kontratës, ndërsa mbështetja nga subjektet e tjera të shërbejë vetëm si kapacitet plotësues dhe jo si zëvendësim i plotë i aftësisë teknike dhe profesionale të operatorit ofertues.

Gjithashtu, në bazë të Nenit 21 pika 2 të Ligjit N.162 / 2020 Per Prokurimin Publik, të ndryshuar, Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 2 të VKM Nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", të ndryshuar, njësia e prokurimit pranë Autoritetit Kontraktor Shoqeria Rajonale Ujësjiellës Kanalizimeve, Shkodër Sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas përcaktimeve në Kriteret e Përgjithshme të Perzgjedhjes / Kualifikimit pika 1 e Shtojcës 7

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në kërkesat e pikes 1, Shtojca 7

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit **2023, 2024, 2025** të konfirmuara me vulë pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë sipas nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

2.2.2. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit **2023, 2024, 2025** lëshuar nga Administrata Tatimore, ku xhiro mesatare e këtyre tre viteve të jetë me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vertetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar (të vitit **2026**) sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia ose Komuna në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 pika 1/b dhe 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” te ndryshuar, ku përcaktohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: b) **gjendjen ekonomike dhe financiare;** ...3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar, **paragrafi 1 dhe 2 germa “b”**, parashikohet: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklarave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare¹. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht: Ligjit Nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29 i tij i cili përcakton: “Çdo tatimpagues përgatit **deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme** në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, **duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël**, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji; Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Pika 3.12 e tij, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25 datë 10.05.2018 “Per Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni9 ku parashikohet: “Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj. Periudha raportuese fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor. Përjashtimet për veprimtaritë e veçanta, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, miratohen nga ministri përgjegjës për financat”; Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”. Në keto kushte, vlerësojmë të kërkojmë kete dokumentacion pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës** bilancin kontabël së bashku me anekset e tij si dhe akt ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Njësia e prokurimit kerkoi edhe **pagesat e taksave vendore** bazuar në Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”(te ndryshuar), neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga çdo njesi e qeverisjes vendore si dhe faktit se në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë rregjistrin tregtar dhe për qëllim të rregjistrimit fiskal, ku përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qenë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet qe ushtrojne aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtem:

Ne rast se punimet jane kryer me ente publike:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme te realizuar me ente publike, duhet te paraqese Kontratën e Sipërmarrjes; formular vleresimi leshuar nga Investitori sipas Shtojces 9;situcion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve;Faturat Tatimore të deklaruara në organet tatimore; Aktin e Kolaudimi; dhe Certifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përhershëm .

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

Ne rast se punimet jane kryer me sektorin privat:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet te paraqese vertetime te shoqeruara me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” te ndryshuar).

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” ku përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 te VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.** Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”

Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qenë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura me objektin e kontratës. Përvojat e mëparshme janë element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Kriteri i kapacitetit teknik siguron se operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedure kanë përvojën dhe ekspertizën e nevojshme për të kryer punën me cilësi të lartë. Përdorimi i operatorëve me përvojë të mëparshme siguron që puna do të kryhet me sukses dhe pa ndërprerje. Përvoja e mëparshme në projekte të ngjashme siguron që operatorët janë të gatshëm për situata të papritura dhe janë në

gjendje të menaxhojnë situatat e mundshme në mënyrën e duhur. Kriteri i kapacitetit teknik ndihmon në sigurimin e një konkurrence të ndershme dhe të përshtatshme në procedure.

Referuar këtij neni, njësia e prokurimit vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentave ligjore të zbatimit të punimeve, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit”(i ndryshuar), si dhe akteve dhe VKM te dala në zbatim të tij, pasi duke qenë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b, të paraqesin dhe situacionet përfundimtare si dhe formular vleresimi për punët e kryera me entet publike. Kjo bëhet me qëllim që autoriteti kontraktor të bindet nëse operatori ekonomik zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës, ku punimet e mëparshme duhet të kenë zëra të konsiderueshme punimesh me zërat e punimeve që po prokurohen, si dhe në rastin kur punimet e mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë, nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim, në vërtetimet që lëshojnë autoritetet kontraktore dhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Meqënëse paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që Autoriteti të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkimi i dokumentacionit të përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

Gjithashtu është kërkuar në DST:

➤ Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet te paraqesë edhe Kontraten e bashkimit te operatoreve shoqeruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku te cilësohen punimet qe ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.

➤ Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: *Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku te cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE, sipas parashikimeve të nenit 88 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni autoriteti kontraktor ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.*

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor është kërkuar edhe miratimi nga ana e autoritetit kontraktor, si nënkontraktor i deklaruar, në respektim të parashikimeve të nenit 89 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Dokumentacioni i kërkuar si më sipër, është kërkuar me qëllim që Autoriteti Kontraktor të përllogarisë vlerën e saktë të kontratave të mëparshme të realizuara nga ofertuesi, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.3.1.

Duke qenë se paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që A.K., të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese

të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkitimi i dokumentacionit përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

Kriteret e mëposhtme teknike nga pika 2.3.2 dhe ne fund janë propozuar dhe vendosur nga specialisti i fushës, pjesë e njësisë së prokurimit, sipas përcaktimit të nenit 74, dhe 78 të VKM nr. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik si dhe njoftimit nr. 4916/2 prot, datë 14.07.2022, pika 1, të Agjencisë së Prokurimit Publik “**Mbi organizmin e Procedurave të Prokurimit Publik**”

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës

- a) Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se disponon liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë kriter, duhet të paraqesë liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për Miratimin e Rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve Juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë profesionale të shoqërisë, të vlefshme, për kategoritë e mëposhtme:

- | | |
|--|---|
| • Kategoria NP- 1 Punime gërmimi në tokë | Klasifikimi C |
| • Kategoria NP- 4 Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai..... | Klasifikimi B |
| • Kategoria NP- 11 Nderime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve | linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë. |
| • Kategoria NP- 7 Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa,.... | Klasifikimi A |
| • Kategoria NP-12 Punime të inxhinierisë mjedisore | Klasifikimi D |
| • Kategoria NS-1 Punime për prishje të ndetimeve | Klasifikimi A |
| • Kategoria NS-18 Punime topogjeodezike | Klasifikimi A |
| | Klasifikimi C |

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet t'i disponojë në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim / kontratën e bashkëpunimit.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin / njehsimin e liçencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht s'kualifikues.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **aftësinë teknike dhe**

profesionale;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”.

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” përcaktohet “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) **licenca profesionale** të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”

VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 të ndryshuar “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2, 3 dhe 4). Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate, në mbështetje të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (të ndryshuar), si dhe në zbatim të VKM Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë në liçensën profesionale për zbatimin e punimeve, kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënllorit të objektit të punimeve, si dhe klasifikimin në nivelet e kërkuara për çdo kategori punimesh, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë proporcionale me objektin e kontratës. Llojet e licencave dhe niveli i klasifikimit të tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlllogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt. Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategoritë respektive është kërkuar bazuar në zërat e punimeve që parashikohen të kryhen dhe që përfshihen në kategorinë përkatëse brenda vlerave të kufijve të parashikuara në VKM Nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar.

Sipas VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 të ndryshuar, përcaktohet:

Në mbështetje të objektit të kontratës “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për zonën e Shirokës, Bashkia Shkodër”, kërkesa që Operatori Ekonomik të disponojë licencë profesionale të vlefshme për kategoritë NP-1, NP-4, NP-11, NP-7, NP-12, NS-1 dhe NS-18 lidhet drejtpërdrejt me natyrën, kompleksitetin teknik, shtrirjen dhe volumnin e punimeve të parashikuara në preventiv.

Bazuar në vlerën e preventivit rezulton se objekti përbëhet nga disa nënobjekte të ndërlidhura funksionalisht: rrugët hyrëse; linja e transmetimit nga Depot Tepe në Shkodër deri te puseta PR në Shirokë; ndërtimi i STP1 dhe ndërhyrjet në depot ekzistuese; stacioni i pompave në Shirokë; furnizimi me energji elektrike; ndërtimi i depos së re 50 m³; ndërtimi i linjave të rrjetit shpërndarës dhe sistemi i komandimit/matjes automatike. Vetëm linja e transmetimit ka vlerë 159,867,914 lekë, ndërsa rrjeti shpërndarës 123,092,203 lekë, kundrejt shumës së analizave prej 328,200,900 lekë.

1. Kategoria NP-1 – Punime gërmimi në tokë – Klasifikimi C

Kategoria NP-1 është drejtpërdrejt e lidhur me një nga proceset kryesore të realizimit të objektit, pasi ndërtimi i linjave të ujësjellësit kërkon hapjen e kanaleve në tokë dhe shkëmb, gërmime për veprat e artit, stacionet e pompimit dhe depot, si dhe mbushjen dhe ngjeshjen e kanaleve pas vendosjes së tubacioneve.

Vetëm në nënobjektin H – Rrjeti shpërndarës, preventivi parashikon ndër të tjera: gërmim kanalesh në tokë të fortë: 350 m³; gërmim shkëmbi të copëtuar: 538 m³; gërmim dheu me ekskavator: 3,465.5 m³; gërmim shkëmbi mesatar me çekiç/ekskavator: 6,577.6 m³; mbushje, rrafshim dhe ngjeshje: 12,000 m³; transport materialesh/dheu: 6,919.6 m³.

Këtyre volumeve u shtohen gërmimet e linjës së transmetimit, ku parashikohen gërmime dheu dhe shkëmbi në mijëra m³, si dhe gërmimet për rrugët hyrëse, stacionet e pompimit dhe depon e re. Për shembull, vetëm rrugët hyrëse përfshijnë 326.9 m³ gërmim dheu, 473.6 m³ gërmim shkëmbi të copëtuar dhe 123.4 m³ gërmim shkëmbi me çekiç, pra mbi 900 m³ gërmime.

Edhe depoja e re 50 m³ kërkon gërmime themeli dhe kanalesh, përfshirë 266.87 m³ gërmim themeli në shkëmb, 65 m³ gërmim kanalesh dhe 49 m³ gërmim me krahë.

Për rrjedhojë, NP-1 nuk përfaqëson një punim sporadik apo ndihmës, por një kategori pune që shtrihet pothuajse në të gjithë gjatësinë dhe territorin e ndërhyrjes. Kërkesa për Klasifikimin C lidhet me volumin e konsiderueshëm dhe shpërndarja e gërmimeve në disa nënobjekte, si dhe nga fakti që gërmimet kryhen në kushte të ndryshme gjeologjike, përfshirë tokë të fortë, shkëmb dhe zona me prani uji.

2. Kategoria NP-4 – Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj etj. – Klasifikimi B

Kërkesa për NP-4 lidhet me ndërhyrjet e konsiderueshme që realizohen në trupin e rrugëve ekzistuese gjatë ndërtimit të linjave të transmetimit dhe shpërndarjes dhe me detyrimin për rikthimin e tyre në gjendjen përfundimtare.

Në linjën e transmetimit parashikohet: prerje asfalti me disk në të dy anët: 11,214 m²; skarifikim i shtresës së asfaltit ekzistues; prishje shtrese çakelli: 5,753 m²; shtresë çakelli 20 cm: 7,365.6 m²; shtresë stabilizanti 10 cm: 7,365.6 m²; spërkatje me emulsion bituminoz: 7,365.6 m².

Më tej, rikonstrukcioni i plotë i paketës rrugore përfshin 8,184 m² shtresë binderi 6 cm dhe 8,184 m² shtresë asfaltobetoni 4 cm.

Edhe rrjeti shpërndarës kërkon prerje, prishje dhe rikthim të 3,471.3 m² rrugë të pashtuara dhe 2,718.7 m² rrugë të asfaltuara, krahas ndërhyrjeve në trotuare dhe sipërfaqe betoni.

Pra, kemi ndërhyrje rrugore në mijëra metra linearë dhe mijëra metra katrorë, që përfshijnë jo vetëm prishjen, por realizimin e paketës së plotë të shtresave dhe asfaltimin. Në këtë kuptim, NP-4, Klasifikimi B, është proporcional me volumin e punimeve rrugore që shoqërojnë ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit.

3. Kategoria NP-11 – Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve, linja e TN/TM dhe shpërndarjen e energjisë – Klasifikimi A

Kjo kategori lidhet drejtpërdrejt me nënobjektin E – “Punime për furnizimin me energji elektrike” dhe me pajisjet elektrike që sigurojnë funksionimin e stacioneve të pompimit dhe të sistemeve të objektit.

Preventivi parashikon ndër të tjera: 11 shtylla B/A për linja 0.4–10 kV; shtrirje dhe tërheqje përcjellësish në një gjatësi prej 1.62 km; traversa metalike për linjat 0.4–10 kV; izolim elektrik të linjave 6–10 kV; tokëzim dhe matje të rezistencës së tokëzimit.

Objekti përfshin gjithashtu transformator 10/20/0.4 kV, 180 kVA, si dhe ndarës TM 20 kV/400 A dhe elementet e nevojshme për instalimin e plotë të sistemit.

Për shkak të karakterit të specializuar të këtyre punimeve dhe faktit se kemi linjë TM, transformator dhe pajisje të shpërndarjes së energjisë, NP-11 është kategori e domosdoshme, ndërsa Klasifikimi A është në përputhje me përmasën ekonomike të kësaj pjese specifike të punimeve.

4. Kategoria NP-7 – Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje – Klasifikimi D

Kjo është kategoria kryesore dhe më e rëndësishme e objektit, pasi vetë kontrata ka si objekt ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit.

Vetëm linja e transmetimit nga Depot Tepe deri në Shirokë përfshin 6,095 ml tubacion PE DN 200, PN16, si dhe pjesë speciale çeliku, saraçineska, ajrujes, valvula moskthimi, flanaxha, puseta dhe pajisje të tjera hidraulike.

Rrjeti shpërndarës përfshin një gamë të gjerë diametrash, ndër të tjera: PE Ø250 mm – 136 ml; PE Ø200 mm – 540 ml; PE Ø160 mm – 493 ml; PE Ø125 mm – 205 ml; PE Ø90 mm – 1,966 ml; si dhe diametra të tjerë të rrjetit.

Preventivi evidenton testim dhe dezinfektim të linjave për 12,231 ml, si dhe 1,146 m tubacion PE Ø75 mm, çka demonstroi qartë shtrirjen kilometrike të rrjetit shpërndarës.

Për këtë arsye, NP-7 – Klasifikimi D është kërkesa themelore e licencimit për realizimin e kontratës, e justifikuar si nga vlera, ashtu edhe nga gjatësia e tubacioneve, diametrat, presionet e punës, veprat e artit, stacionet e pompimit dhe kompleksiteti hidraulik i sistemit.

5. Kategoria NP-12 – Punime të inxhinierisë mjedisore – Klasifikimi A

NP-12 lidhet me karakterin e përgjithshëm të ndërhyrjes infrastrukturore dhe me punimet që ndikojnë në territorin ku zhvillohet projekti: hapjen dhe rikthimin e traseve, menaxhimin e materialeve të gërmuara, sistemimin e sipërfaqeve, ndërhyrjet në vegjetacion, drenazhimet dhe rehabilitimin e zonave pas përfundimit të punimeve.

Preventivi parashikon, ndër të tjera, prerje dhe sistemim pemësh në zonat e ndërhyrjes, volume të konsiderueshme transporti të dherave dhe materialeve, mbushje dhe ngjeshje, rikthim të rrugëve, trotuareve dhe sipërfaqeve të prekura. Për shembull, vetëm në nënobjektin C parashikohet prerja dhe sistemimi i 100 pemëve, krahas punimeve të gërmimit dhe transportit.

Duke qenë se kjo kategori nuk rezultoi në preventiv me një grup të veçantë zërash të emërtuar shprehimisht “punime të inxhinierisë mjedisore”, argumentimi i NP-12 duhet të mbështetet te karakteri transversal i masave mjedisore të domosdoshme për zbatimin dhe rehabilitimin e territorit, dhe për këtë arsye klasifikimi minimal A është proporcional dhe jo kufizues.

6. Kategoria NS-1 – Punime për prishjen e ndërtimeve – Klasifikimi A

NS-1 lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga preventivi.

Në linjën e transmetimit parashikohet prishje e shtresave të betonit në masën 263 m³.

Në rrjetin shpërndarës parashikohet gjithashtu prishje e 136 m³ shtresave të betonit.

Përveç këtyre zërave specifikë, preventivi përfshin prerjen/prishjen dhe rikthimin e trotuareve, sipërfaqeve të betonit, rrugëve të pashtuara, rrugëve të asfaltuara dhe sipërfaqeve me pllaka guri. Vetëm në rrjetin shpërndarës parashikohen 2,718.7 m² rrugë të asfaltuara dhe 3,471.3 m² rrugë të pashtuara që preken dhe rikthehen.

Pra, punimet e prishjes janë të nevojshme për hapjen e traseve të tubacioneve dhe realizimin e veprave të reja.

7. Kategoria NS-18 – Punime topogjeodezike – Klasifikimi C

Punimet topogjeodezike janë teknikisht të lidhura me realizimin e një rrjeti linear të kësaj përmase, pasi zbatimi i tubacioneve, puseta, stacioneve të pompimit dhe depove kërkon përcaktimin dhe kontrollin e akseve, kuotave, pozicioneve dhe niveleve gjatë gjithë fazës së zbatimit.

Rëndësia e tyre lidhet veçanërisht me shtrirjen kilometrike të objektit: vetëm rrjeti shpërndarës ka testim dhe dezinfektim të parashikuar për 12,231 ml linjë, ndërsa linja kryesore e transmetimit përfshin

6,095	ml	tubacion	DN200.
-------	----	----------	--------

Në një objekt të tillë linear, kontrolli topografik është i nevojshëm për pozicionimin horizontal dhe vertikal të tubacioneve, respektimin e kuotave të projektit, vendosjen e puseta dhe rakorderive, pozicionimin e stacioneve dhe depove dhe dokumentimin përfundimtar të veprës.

b) Çertifikatat që duhet të paraqesin Operatorët Ekonomikë:

- Certifikatë ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, objekti i se cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Certifikatë ISO 14001-2015 “Për Sistemin e menaxhimit të mjedisit”, objekti i se cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Certifikatë ISO 45001-2018 “Për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë”, ose certifikatë me standartin e përditësuar Certifikatë ISO 45001-2023, objekti i se cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Nëse certifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto certifikata të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marrë përsipër të realizojë, referuar kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **aftësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”. Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin **certifikata** të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”*

Duke marrë në konsideratë objektin e kontratës “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për zonën e Shirokës, Bashkia Shkodër”, natyrën komplekse të punimeve, shtrirjen e tyre në disa nënobjekte dhe volumet e konsiderueshme të parashikuara në preventiv, kërkesat për standardet ISO duhet të lidhen me proceset konkrete që Operatori Ekonomik do të menaxhojë dhe realizojë gjatë zbatimit të kontratës.

Preventivi përfshin linjën e transmetimit, rrjetin shpërndarës të ujësjellësit, stacione pompimi, depo uji, punime rrugore, punime gërmimi në tokë dhe shkëmb, ndërhyrje në sipërfaqe ekzistuese, instalime elektrike dhe automatizim.

Certifikatë ISO 9001:2015 – “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë”

Kërkesa që Operatori Ekonomik të disponojë ISO 9001:2015, me objekt certifikimi në përputhje me objektin e prokurimit, lidhet me nevojën për të garantuar një sistem të organizuar të kontrollit dhe menaxhimit të cilësisë gjatë realizimit të të gjitha proceseve të kontratës.

Objekti nuk konsiston në një proces të vetëm ndërtimor, por përfshin njëkohësisht gërmime, mbushje dhe ngjeshje, shtresa rrugore, tubacione nën presion, rakorderi dhe pajisje hidraulike,

konstruksione metalike, betonarme, stacione pompimi, instalime elektrike dhe sisteme automatizimi. Për rrjedhojë kërkohet koordinim dhe kontroll i vazhdueshëm i materialeve, proceseve të punës, dokumentacionit teknik, inspektimeve dhe provave.

Rëndësia e kontrollit të cilësisë evidentohet veçanërisht nga tubacionet e ujësjellësit. Vetëm linja kryesore e transmetimit përfshin 6,095 ml tub PE Ø200 mm PN16, së bashku me rakorderitë përkatëse. Për këtë linjë parashikohen gjithashtu 6,095 ml pastrim, 6,095 ml dezinfektim dhe 6,095 ml testim të linjës, çka kërkon ndjekje të kontrolluar të cilësisë nga faza e furnizimit dhe montimit deri te testimi dhe vënia në funksion.

Në rrjetin shpërndarës parashikohen gjithashtu testimi dhe dezinfektimi i 12,231 ml tubacionesh, si dhe një numër i madh rakorderish dhe elementësh të rrjetit.

Kërkesa për ISO 9001:2015 është rrjedhimisht e lidhur drejtpërdrejt me garantimin e cilësisë së materialeve, kontrollin e proceseve të instalimit, gjurmueshmërinë, testimin dhe dokumentimin e punimeve, veçanërisht duke pasur parasysh volumin dhe rëndësinë funksionale të rrjetit të furnizimit me ujë.

Certifikatë ISO 14001:2015 – “Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit”

Kërkesa për ISO 14001:2015 lidhet me ndikimet mjedisore që shoqërojnë natyrshëm realizimin e një vepre infrastrukture të kësaj shtrirjeje.

Punimet zhvillohen në një territor të gjerë dhe përfshijnë gjurmime masive, transport të dherave dhe materialeve, ndërhyrje në rrugë dhe sipërfaqe ekzistuese, prerje pemësh, punime në prani uji dhe rikthimin e zonave të prekura.

Për shembull, në nënobjektin e rrugëve hyrëse parashikohet prerja dhe sistemimi i 221 pemëve, gjurmime në tokë dhe shkëmb dhe mbushje e ngjeshje të materialit të gërmuar.

Në nënobjektin STP1 parashikohen gjithashtu 100 pemë për prerje dhe sistemim, si dhe gjurmime në shkëmb e tokë me prani uji dhe transport të materialeve.

Rrjeti shpërndarës kërkon ndërhyrje të konsiderueshme në infrastrukturën ekzistuese dhe rikthimin e: 776.3 m² trotuare me pllaka; mijëra m² sipërfaqe betoni; 3,471.3 m² rrugë të pashtruara; 2,718.7 m² rrugë të asfaltuara; si dhe sipërfaqe me pllaka guri.

Këto procese krijojnë nevojën për administrimin e materialeve të gërmuara, mbetjeve nga prishjet, pluhurave, zhurmës, lëvizjes së makinerive dhe rehabilitimit të sipërfaqeve të prekura. Për këtë arsye, sistemi i menaxhimit sipas ISO 14001:2015 lidhet në mënyrë proporcionale me identifikimin, kontrollin dhe minimizimin e ndikimeve mjedisore gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Certifikatë ISO 45001:2018 ose ISO 45001:2023 – “Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë”

ISO 45001 lidhet drejtpërdrejt me rrezikshmërinë dhe natyrën e proceseve që parashikon preventivi.

Punimet përfshijnë gjurmime të thella, punime në kanale, gjurmime shkëmbore me makineri dhe çekiç, përdorimin e ekskavatorëve dhe mjeteve të rënda, ndërhyrje në rrugë në kushte trafiku, punime metalike, punime elektrike në tension të mesëm, instalim të pajisjeve të pompimit dhe punime në lartësi apo struktura.

Në linjën kryesore parashikohet në mënyrë të posaçme mbrojtja e kanalit me palankola për thellësi mbi 1.7 m deri në 6 m, në një sipërfaqe prej 8,126.3 m².

Ky është një tregues i drejtpërdrejtë i rrezikut profesional, pasi punimet në kanale të thella kërkojnë menaxhim të kontrolluar të rrezikut të shembjes, hyrje-daljes së punonjësve, operimit të makinerive dhe mbrojtjes së kantierit.

Preventivi përfshin gjithashtu punime elektrike në linja 0.4–10 kV, me 11 shtylla, shtrirje dhe tërheqje përcjellësish për 1.62 km, punime izolimi në linja 6–10 kV dhe sisteme tokëzimi.

Prandaj ISO 45001:2018/2023 është e lidhur me nevojën që operatori të ketë një sistem të dokumentuar për identifikimin e rreziqeve, parandalimin e aksidenteve, përdorimin e pajisjeve mbrojtëse, menaxhimin e punimeve të rrezikshme dhe mbrojtjen e personelit dhe palëve të treta gjatë realizimit të objektit.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë si dhe standartet e menaxhimit të mjedisit. Në bazë të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme. Referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimit ka kërkuar certifikatat e mësipërme për te vërtetuar se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime. Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret si më lart duke qenë në përpjesëtim dhe të lidhura me objektin e kontratës, por edhe sepse ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin e besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

c) Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë:

- ✓ Tuba Ujësjellësi
- ✓ Rakorderi
- ✓ Matesa uji
- ✓ Elektropompa
- ✓ Pompe Zhytese

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet në gjuhën zyrtare shqipe ose angleze.
- Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përket.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Shënim: Të gjitha normat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standarteve shqiptare

SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtori.

d) Për matësat e ujit

- Operatori Ekonomik të paraqesë certifikatë ose deklaratë nga prodhuesi / distributori i autorizuar që vërteton se standarti i prodhimit të matesave të ujit është sipas OIML R49 / ekuivalente me të, sipas rekomandimeve të Organizatës Internacionale të Metrologjisë Ligjore.
- Operatori Ekonomik të paraqesë certifikaten e aprovimit sipas MID /ekuivalente me të, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9875 datë 14.02.2008 ndryshuar me Ligjin Nr. 10217 datë 21.01.2010, Ligjin Nr. 14/2013 dhe Ligjin Nr. 100/2015.

Argumentimi: Paraqitja e ketyre dokumenteve është vlerësuar pasi në objekt kemi të bëjmë me materiale (artikuj) që do të vendosen në vepër, bazuar në dispozitat e sipërcituara dhe referuar nenit 40 pika 6 të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duhet që këto artikuj të plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike e përcaktuara në objektin e kontratës, ku për vërtetimin e përmbushjes së tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: **Autorizim prodhuesi ose distributori, katalogët ose pjesë të tyre**, me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Ky objekt, një ndër elementet më të rëndësishëm të tij ka cilësinë e materialeve tubacione të ujësjellësit, matësa etj, që do të vendosen në objekt, cilësinë e zbatimit të punimeve dhe atë të artikujve, në mënyrë që të arrijë qëllimet e tij afatgjata.

Në mbështetje të nenit 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kërkesën për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit, autorizimit të distributorit të autorizuar nga prodhuesi ose marrëveshjes së bashkëpunimit, si dhe katalogëve teknikë për materialet dhe pajisjet kryesore të sistemit të furnizimit me ujë.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është një kriter i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për të siguruar transparencën, cilësinë dhe besueshmërinë në procesin e blerjes së artikujve të sipërcituar. Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose distributorit siguron që operatori ekonomik është kompetent në fushën e caktuar. Ky dokument tregon se operatori ekonomik ka marrë leje zyrtare nga prodhuesi ose distributori për të ofruar mallrat e tyre në treg. Përmes këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor mund të sigurohet që operatorët ekonomikë janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto produkte. Gjithashtu kriteri për paraqitjen e autorizimit siguron një burim të qartë të informacionit në rastin e ndonjë verifikimi të nevojshëm nga ana e Autoritetit Kontraktor. Përmes informacionit të plotë të Prodhuesit, Autoriteti ka mundësi të kontaktoje me Prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pa vonesë. Kriteri për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit nënkupton që operatori ekonomik është përgatitur për të dokumentuar dhe provuar lidhjen midis tyre dhe prodhuesit të mallrave. Ky dokument siguron që operatori ekonomik është i aftë të bëjë bashkëpunim me prodhuesin dhe të sigurojë furnizimin e vazhdueshëm të mallrave. Përmes këtij kriteri, blerësit mund të sigurohen që operatori ekonomik ka arritur një marrëveshje të zyrtarizuar dhe të qëndrueshme me furnizuesin e tyre.

Vendosja e kriterit për **paraqitjen e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit** është i domosdoshëm për disa arsye të rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e procesit të blerjes dhe realizimit të furnizimit të mallrave. Ky kriter ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara. Paraqitja e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit jep një informacion të qartë në lidhje me mallrat që do të ofrohen. Ky informacion përfshin të dhëna të detajuara rreth materialeve dhe karakteristikave të mallrave. Kjo siguron që Autoriteti të ketë një pamje të qartë për cilësinë dhe aftësitë e mallrave që ofrohen dhe mund të bëjnë një vlerësim të mirë të ofertave. Kriteri për paraqitjen e fragmenteve të katalogut nënkupton se operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara për mallin e planifikuar. Kjo siguron që mallrat e ofruara janë të pajtueshme me kërkesat e tenderit dhe janë të përshtatshme për detyrën specifike. Gjithashtu, bazuar në preventivin e punimeve, ku përveç vendosjes është parashikuar dhe furnizimi i materialeve, referuar natyrës së tyre, ato duhet të jenë të një cilësie të mirë, referuar kostos së tyre dhe funksionit që kanë, me qëllim që të kenë një jetëgjatësi përtej periudhës së garancisë që kanë, vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga do t'i sigurojnë këto materiale objekt kontrate, katalogët e pajisjeve/ materialeve si dhe dokumentacionin me të dhënat e këtyre materialeve, me qëllim verifikimin/ vlerësimin nga Autoriteti nëse këto materiale/ pajisje për të cilat do të ofertojnë operatorët ekonomikë pjesëmarrës janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat e tenderit, si dhe janë të prodhuara nga prodhues të çertifikuar për prodhimin e tyre me cilësi dhe brenda standarteve të miratuara.

Kërkesa që Operatori Ekonomik të paraqesë Autorizim Prodhuesi / autorizim nga distributori i autorizuar / marrëveshje bashkëpunimi, si dhe katalogë ose fragmente katalogësh për artikujt: tuba ujësjellësi, rakorderi, matësa uji, elektropompa dhe pompa zhytëse, lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe peshën e këtyre produkteve në realizimin e objektit “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për zonën e Shirokës, Bashkia Shkodër”.

Këto mallra nuk përbëjnë materiale të rastësishme apo me përdorim periferik në kontratë. Ato janë elemente funksionale të sistemit hidraulik dhe mekanik, nga cilësia, origjina dhe përputhshmëria teknike e të cilave varet funksionimi i rrjetit të ujësjellësit, stacioneve të pompimit dhe sistemit të matjes së konsumit. Fleta përmbledhëse e preventivit tregon se vetëm linja e transmetimit ka vlerë 159,867,914 lekë dhe rrjeti shpërndarës 123,092,203 lekë, ndërsa kontrata përfshin edhe STP1, stacionin e pompave në Shirokë dhe pajisjet përkatëse.

1. Tuba ujësjellësi

Kërkesa për dokumentacion që provon lidhjen e ofertuesit me prodhuesin/distributorin e tubave lidhet së pari nga volumi shumë i lartë i tubacioneve të parashikuara.

Vetëm linja e transmetimit përmban:

6,095 ml tuba dhe rakorderi PE Ø200 mm, PN16, me një vlerë prej 30,229,737.20 lekë vetëm për këtë zë. Për të njëjtën linjë parashikohen më pas pastrim, dezinfektim dhe testim për të gjithë gjatësinë 6,095 ml.

Në rrjetin shpërndarës parashikohen ndër të tjera: PE Ø250 mm PN10 – 136 ml; PE Ø200 mm PN10 – 540 ml; PE Ø160 mm PN10 – 493 ml; PE Ø125 mm PN10 – 205 ml; PE Ø90 mm PN10 – 1,966 ml.

Preventivi përmban gjithashtu 1,146 ml tub PE Ø75 mm PN10, ndërsa testimi dhe dezinfektimi i rrjetit shpërndarës shtrihet në 12,231 ml.

Në këto kushte, tubat janë një nga materialet themelore dhe me konsum më të madh në kontratë. Autorizimi i prodhuesit/distributorit dhe katalogu teknik shërbejnë për të identifikuar paraprakisht prodhuesin, tipin e tubit, diametrin, klasën e presionit, materialin dhe karakteristikat teknike që do të ofrohen, duke mundësuar verifikimin e përputhshmërisë me specifikimet teknike.

2. Rakorderitë

Rakorderitë përbëjnë një sistem të tërë komponentësh që sigurojnë bashkimin, degëzimin, ndryshimin e diametrit, kontrollin dhe izolimin e tubacionit.

Preventivi përmban një numër të madh elementësh PE100 dhe metalikë, si: stafe EF PE100 PN16; manikota EF PE100 PN10; reduksione EF; Tee PE100 PN10; fllanxha dhe adaptorë çeliku; xhunto gize; kundralvula; saraçineska; ajruer të diametrave të ndryshëm.

Vetëm në një pjesë të preventivit evidentohen, ndër të tjera, 27 manikota EF PE100 DN110, 52 manikota DN63, 38 fllanxha-adaptor DN50, 32 fllanxha-adaptor DN65, si dhe dhjetëra elemente të tjera sipas diametrave të rrjetit.

Po kështu, preventivi parashikon një numër të madh Tee PE100 në kombinime të ndryshme diametrash, nga Ø63 deri në Ø160.

Këto rakorderi duhet të jenë teknikisht kompatible me tubacionet që do të vendosen. Prandaj kërkesa për autorizim dhe katalog nuk lidhet vetëm me origjinën tregtare të produktit, por edhe me garantimin e kompatibilitetit dimensional, klasës së presionit dhe konfigurimit teknik të të gjithë sistemit.

3. Matësat e ujit

Kërkesa për autorizim prodhuesi dhe katalog për matësat e ujit është e lidhur drejtpërdrejt me numrin, llojin dhe funksionin e tyre në rrjet.

Preventivi përmban, ndër të tjera: 1 matës uji DN50; 2 matësa uji DN150; 6 matësa uji tip turbine DN100, $Q = 36 \text{ m}^3/\text{orë}$.

Për rrjetin shpërndarës parashikohen gjithashtu sisteme kolektorësh për matësa individuale: 104 kolektorë për 2 matësa uji; 45 kolektorë për 3 matësa uji; 11 kolektorë për 4 matësa uji; 4 kolektorë për 6 matësa uji.

Vetëm këto katër kategori kolektorësh krijojnë kapacitet për instalimin e qindra pikave të matjes së konsumit. Për rrjedhojë, matësi i ujit është një pajisje thelbësore e sistemit dhe jo një artikull i parëndësishëm në raport me kontratën.

Kërkesa për katalog është e nevojshme që Autoriteti Kontraktor të mund të verifikojë parametrat e pajisjes së ofruar, si diametri nominal, kapaciteti i matjes, karakteristikat metrologjike, klasa dhe karakteristika të tjera të përcaktuara në specifikimet teknike.

4. Elektropompat dhe pompat zhytëse

Edhe pajisjet e pompimit lidhen drejtpërdrejt me funksionin bazë të sistemit, pasi objekti përfshin ndërtimin e stacioneve të pompimit dhe transportimin e ujit në nivelet dhe presionet e projektuara.

Në STP1 preventivi parashikon vendosjen e një pompe me parametra:

$Q = 5 \text{ l/s}$, $H = 66 \text{ m}$, $N = 11 \text{ kW}$, të kompletuar dhe të gatshme për punë.

Në nënobjektin “Stacioni i pompave në Shirokë” parashikohen edhe pompa zhytëse, të cilat përbëjnë pajisje kryesore për funksionimin e stacionit. Kjo tregon se përzgjedhja e prodhuesit nuk lidhet vetëm me furnizimin e një malli standard, por me pajisje elektromekanike që duhet të plotësojnë parametrat e projektuar të debitit, lartësisë manometrike, fuqisë, eficiencës dhe kushteve të funksionimit.

Për këtë arsye, autorizimi nga prodhuesi/distributori dhe katalogu teknik krijojnë mundësinë e verifikimit të modelit konkret të pompës dhe pikës së saj të punës, çka është thelbësore që pajisja e ofruar të jetë reale dhe e përshtatshme për projektin.

Referuar preventivit, artikujt e përzgjedhur janë materiale dhe pajisje që kanë volum të konsiderueshëm; janë të integruara drejtpërdrejt në sistemin përfundimtar; duhet të plotësojnë parametra të përcaktuar teknikë; duhet të jenë të kompatibilizuara me njëra-tjetrën; ndikojnë drejtpërdrejt në jetëgjatësinë dhe funksionimin e rrjetit.

Për këtë arsye, kërkesa për Autorizim Prodhuesi / Distributori të autorizuar / Marrëveshje bashkëpunimi është një mekanizëm për të provuar që operatori ka një burim konkret furnizimi për produktet e propozuara dhe se Autoriteti Kontraktor mund të verifikojë zinxhirin ofertues–distributor–prodhues.

Kërkesa që autorizimi të përmbajë të dhënat e prodhuesit dhe të jetë i vlefshëm deri në realizimin e plotë të punimeve lidhet me nevojën për gjurmueshmëri të furnizimit dhe vazhdimësi të burimit të produkteve gjatë zbatimit të kontratës, sidomos kur kemi mbi 6 km linjë transmetimi dhe mbi 12 km rrjet që i nënshtrohet testimit dhe dezinfektimit.

Katalogu ose fragmenti i katalogut ka një funksion tjetër nga autorizimi. Autorizimi provon lidhjen tregtare me burimin e furnizimit, ndërsa katalogu lejon verifikimin e produktit konkret të propozuar.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme për artikuj të tillë si tubat dhe rakorderitë, ku preventivi përcakton diametra dhe presione të ndryshme; matësat e ujit, ku kërkohen dimensione dhe kapacitete të caktuara; dhe pompat, ku përputhshmëria duhet kontrolluar sipas debitit, presionit/lartësisë manometrike dhe fuqisë.

Në këtë kuptim, kërkesa që fragmenti i katalogut të identifikojë qartë prodhuesin dhe katalogun nga i cili është marrë është e lidhur me nevojën që dokumenti i paraqitur të jetë i verifikueshëm dhe i lidhur pa ekuivok me produktin e ofruar.

7. Matësat e ujit – standardi OIML R49 ose ekuivalent

Kërkesa që për matësat e ujit të paraqitet certifikatë ose deklaratë që vërteton prodhimin sipas OIML R49 ose ekuivalent lidhet me faktin se këto pajisje përdoren për matjen e sasisë së ujit të furnizuar, pra kanë funksion matës dhe jo thjesht hidraulik.

Preventivi evidenton matësa të dimensioneve të ndryshme, përfshirë DN50 dhe DN150, si dhe 6 matësa tip turbine DN100 me kapacitet $Q = 36 \text{ m}^3/\text{orë}$.

Për më tepër, rrjeti përfshin qindra pozicione të mundshme matjeje përmes kolektorëve të parashikuar në preventiv. Vetëm kolektorët për 2, 3, 4 dhe 6 matësa janë respektivisht 104, 45, 11 dhe 4 copë.

Në këtë kontekst, kërkesa për një standard metrologjik lidhet me nevojën që pajisjet të japin matje të kontrollueshme dhe të besueshme të konsumit, pasi gabimi i matjes, stabiliteti dhe performanca e pajisjes ndikojnë drejtpërdrejt në administrimin e rrjetit dhe faturimin e konsumit.

8. Matësat e ujit – aprovimi MID ose ekuivalent

Edhe kërkesa për certifikatën e aprovimit MID ose ekuivalent lidhet me karakterin e matësit si instrument matës.

Ndryshe nga tubacioni apo rakorderia, matësi i ujit duhet jo vetëm të përballojë kushtet hidraulike të sistemit, por edhe të realizojë funksionin e matjes sipas kërkesave përkatëse metrologjike.

Duke qenë se preventivi përfshin si matësa me dimensione më të mëdha për kontrollin e rrjetit, ashtu edhe një numër të konsiderueshëm pozicionesh për matje individuale, verifikimi i konformitetit metrologjik të pajisjeve ka lidhje funksionale me objektin e kontratës.

Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) përcaktohet se, citojmë: **“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. 2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.**

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse, si më poshtë:

- a) Operatori Ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë punësuar minimalisht **80 (tetedhjetë)** punonjës për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën e mesiperme në Formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mesiperme.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të paraqitura dhe të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mesiperme.

Argumentim: Në mbështetje të nenit 77, pika 1 dhe pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar si kriter kualifikimi disponimin e një numri mesatar prej jo më pak se **80 (tetedhjetë)** punonjësish për periudhën e tre muajve të fundit nga data e hapjes së procedurës së prokurimit.

Kërkesa që operatori ekonomik të ketë të punësuar minimalisht 80 (tetedhjetë) punonjës është përcaktuar në raport me natyrën, përmasat, kompleksitetin teknik dhe volumin e konsiderueshëm të punimeve që përmban objekti i kontratës, si dhe me nevojën për organizimin e njëkohshëm të disa fronteve të punës.

Nga preventivi rezulton se objekti nuk përfaqëson vetëm ndërtimin e një linje ujësjellësi, por është një investim i integruar që përfshin: rrugët hyrëse; linjën e transmetimit nga Depot Tepe në Shkodër deri te puseta PR në Shirokë; ndërtimin e Stacionit të Pompave STP1 dhe ndërhyrje në dy depot ekzistuese; stacionin e pompave në Shirokë; punimet e furnizimit me energji elektrike; ndërtimin e depos së re 50 m³; ndërtimin e linjave të rrjetit shpërndarës të ujësjellësit; si dhe sistemin e komandimit automatik të pompave, matjen automatike të presionit dhe matjen automatike me sensorë të nivelit në tre depot.

Për rrjedhojë, realizimi i kontratës kërkon angazhimin e njëkohshëm të fuqisë punëtore në profile dhe procese të ndryshme: punime gërmimi dhe transporti; punime rrugore dhe asfaltimi; montim tubacionesh; ndërtim pusetash dhe veprash betonarme; punime në stacionet e pompimit dhe depot; instalime hidraulike e mekanike; punime elektrike; si dhe instalim dhe konfigurim të sistemeve të automatizimit dhe monitorimit. Volumet konkrete që mbështesin nevojën për fuqi të konsiderueshme punëtore

Vetëm linja e transmetimit përmban volume shumë të mëdha. Preventivi parashikon 11,214 ml prerje asfalti, 1,673.6 m³ mbushje me material të gërmuar, 7,365.6 m² shtresë çakëlli, 7,365.6 m² stabilizant dhe 7,365.6 m² trajtim me emulsion bituminoz.

Për të njëjtën linjë parashikohen 2,531.32 m³ gërmime dheu me ekskavator, 6,004.68 m³ gërmime shkëmbi me makineri, 4,037 m³ transport dheu dhe 8,936 m³ mbushje, rrafshim dhe ngjeshje. Këto volume kërkojnë jo vetëm operatorët e makinerive, por edhe punonjës për drejtimin e punimeve, sistemimin e traseve, sigurimin e kantierit, punimet manuale dhe mbështetjen e mjeteve mekanike.

Një nga zërat kryesorë është furnizimi dhe vendosja e 6,095 ml tubacion PE DN 200 PN16. Për të njëjtën gjatësi parashikohen veçmas pastrimi, dezinfektimi dhe testimi i linjës. Kjo tregon se puna nuk përfundon me shtrimin e tubit, por kërkon ekupe për montimin, bashkimin, instalimin e pjesëve speciale, provat, pastrimin dhe vënien në funksion. Po në linjën e transmetimit parashikohet ndërtimi i 40 pusetave kryesore prej betoni 2×2 m, me thellësi 2.5–3.5 m, si dhe 8,126.3 m² mbrojtje kanali me palankola për thellësi mbi 1.7 m deri në 6 m. Këto janë procese me intensitet të lartë pune dhe kërkojnë personel të specializuar dhe ndihmës për punimet e betonit, armaturës, montimit, sigurimit të gërmimeve dhe manipulimit të materialeve.

Rrjeti shpërndarës krijon një front tjetër të madh pune

Krahas linjës së transmetimit, preventivi përmban një nënobjekt të veçantë për ndërtimin e linjave të rrjetit shpërndarës të ujësjellësit të Shirokës. Vetëm në pjesën e evidentuar të rrjetit shpërndarës

parashikohen: 136 ml tub PE DN250, 540 ml DN200, 493 ml DN160, 205 ml DN125 dhe 1,966 ml DN90, pra mbi 3.3 km tubacione vetëm në këto zëra. Kjo pjesë e kontratës përmban gjithashtu 4,557.1 m³ nënshtresë, 2,962.5 m³ shtresë rëre, punime betoni dhe prishje shtresash ekzistuese.

Kjo mbështet organizimin e ekipeve të veçanta për linjën e transmetimit dhe rrjetin shpërndarës, në vend që e gjithë kontrata të realizohet nga një ekip i vetëm në mënyrë të njëpasnjëshme.

Stacionet e pompimit dhe objektet ndërtimore

Objekti përmban paralelisht punime ndërtimore në stacionet e pompimit dhe depot. Për stacionin e pompave në Shirokë parashikohen struktura betonarme për plinta, kolona, trarë dhe soleta, si dhe sasi të konsiderueshme hekuri për beton. Vetëm trarët betonarme C20/25 janë rreth 169.66 m³. Në këtë nënobjekt ka gjithashtu gjermime, transport dheu, punime murature, suvatime, hidroizolime, dyer e dritare, instalime hidrosanitare dhe punime të tjera për përfundimin e objektit.

Në një front tjetër ndërtohet depo e re 50 m³, ku preventivi parashikon gjermime mekanike dhe manuale, transport dheu, shtresa, beton dhe struktura betonarme. Pra, krahas ekipeve të tubacioneve, nevojiten ekipe ndërtimi për betonarme, hekur, kallëpe, muraturë, suvatim, hidroizolim dhe punime përfundimtare.

Punimet elektrike, mekanike dhe automatizimi-Nevoja për 80 punonjës lidhet me faktin se kontrata nuk kufizohet në punime civile dhe hidraulike. Preventivi ka nënobjekte të veçanta për furnizimin me energji elektrike dhe për sistemin e komandimit automatik të pompave, matjen automatike të presionit dhe matjen me sensorë të nivelit në tre depot.

Për furnizimin elektrik parashikohen ndër të tjera 11 shtylla betonarme për linja 0.4–10 kV, shtrirje/tërheqje përcjellësish, traversa metalike, izolim elektrik në linjat 6–10 kV dhe tokëzim.

Këto punime kërkojnë personel elektrik dhe elektromekanik të specializuar, i cili nuk mund të zëvendësohet nga punonjësit që realizojnë gjermimet, betonin, asfaltin apo montimin e tubacioneve.

<i>Fronti/procesi kryesor</i>	<i>Nevoja punonjësve</i>
<i>Linja kryesore e transmetimit – gjermim, trase, mbushje, tubacione</i>	<i>20–22</i>
<i>Rrjeti shpërndarës – trase dhe montim tubacionesh</i>	<i>15–17</i>
<i>Puseta, betonarme dhe vepra arti</i>	<i>10–12</i>
<i>Punime rrugore, shtresa dhe rikthim sipërfaqesh</i>	<i>8–10</i>
<i>Stacione pompimi, depo dhe punime ndërtimore</i>	<i>8–10</i>
<i>Punime hidromekanike/montim pajisjesh</i>	<i>5–6</i>
<i>Punime elektrike dhe automatizim</i>	<i>5–6</i>
<i>Personel teknik, drejtues, topografi, siguri dhe mbështetje</i>	<i>6–8</i>

Kjo tregon se në periudhat e mbivendosjes së proceseve, nevoja operative mund të arrijë ose tejkalojë 80 persona. Kjo tabelë duhet trajtuar si analizë e nevojës për burime njerëzore, jo si detyrim që operatori të përdorë pikërisht këtë shpërndarje.

b) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë** të cilët të figurojnë në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, nga data e hapjes së tenderit, si më poshtë:

- | | |
|--------------------------------|---------|
| • Inxhinier Hidroteknik | 2 (dy) |
| • Inxhinier Ndërtimi | 1(nje) |
| • Inxhinier Elektrik | 1 (një) |
| • Inxhinier Gjeoteknik | 1 (një) |
| • Inxhinier Gjeodet / Topograf | 1 (një) |

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

1. Kontratë pune të vlefshme,
2. Diplome,
3. Listepagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës, ku duhet të figurojnë stafi i mësipërm

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM – së 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar përsa i takon ndalimeve të dypunësimit. Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklaratimet e operatorit ekonomik në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Për secilin pjesëtar të stafit inxhinierik të mësipërm Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV (Drejtuesit Teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi).

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Shenim : Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për inxhinieret e mesiperm, emer/mbiemer, atesia, numrin personal te ID , numrin dhe titullin e kualifikimit për diplomën përkatëse, si dhe institucionin qe ka leshuar kete dokument.

c) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin tjetër inxhinierik** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- | | |
|---|---------|
| • Inxhinier Ndërtimi/ Profili Strukturist | 1 (nje) |
| • Inxhinier Mjedisi | 1 (një) |

Për stafin e mësipërm inxhinierik Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune, CV dhe te figuroje ne Listepagesa per te pakten 3 muajt e Fundit.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve*

të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

d) Operatori ekonomik pjesëmarrës, në zbatim të Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, duhet të përcaktojë me anë të një **deklarate** (nënshkruar nga Administratori i Shoqërisë), **Drejtuesin Teknik të punimeve** (inxhinier me eksperiencë) në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërise dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

❖ *Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetedeklarimin sipas Formularit të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës Nr.8“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si më poshtë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës se zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV.*

e) Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë të punësuar stafin teknik të përbërë nga punonjës të specializuar dhe të certifikuar sipas profesionit që kryejnë dhe të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit, duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit, me profesione si më poshtë:

- 2 (dy) teknike ndertimi
- 1 (një) teknik topograf
- 1 (një) teknik hidraulik
- 5 (pesë) hidraulike
- 3 (tre) specialiste karpentier
- 3 (tre) betonues
- 3 (tre) hekurkthyes
- 2 (dy) pllakashtrues
- 2 (dy) asfaltoshtrues
- 3 (tre) saldatore
- 2 (dy) elektrikist
- 2 (dy) mekanik
- 2 (dy) specialist ndertimi
- 2 (dy) murator
- 2 (dy) suvatues
- 2 (dy) bojaxhi
- 2 (dy) hidroizolues
- 2 (dy) përgatitës të konstruksioneve metalike

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune të vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, diplomë profesionale / dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike / private të licencuara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Për specialistët e mësipërm të paraqiten kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme, të lëshuara nga institucione shtetërore ose nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve.

Shënim: Për shoferët, Operatori Ekonomik pjesëmarrës mund t'i disponojë edhe të kontraktuar me kontratë pune / shërbimi për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

f. Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të paktën:

- 3 (tre) shofere për drejtim mjetesh të pajisur me leje drejtimi me kategorinë ”C” dhe certifikate e aftësisë profesionale (CAP), lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.
- 3 (tre) Eskavatoristë
- 2 (dy) Automakinist

të cilët mund të jenë pjesë e stafit ose të kontraktuar me kontratë pune / shërbimi, për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

Për secilin pjesëtar të stafit të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune / shërbimi të vlefshme; Dëshmi e aftësisë profesionale (të vlefshme) lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë **burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, **si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.**” Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar,

parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe /ose c) **fuqinë punëtore të operatorit ekonomik** të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Kërkesa që Operatori Ekonomik të ketë të punësuar minimalisht 80 punonjës për periudhën e 3 muajve të fundit, duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit, lidhet me volumin e lartë të kontratës, shumëllojshmërinë e proceseve teknologjike, shtrirjen e punimeve në disa nënobjekte dhe nevojën për realizimin e tyre brenda afatit kontraktual prej 18 muajsh.

Objekti nuk përbëhet nga një proces i vetëm ndërtimor, por nga disa fronte pune që përfshijnë njëkohësisht linjën e transmetimit, rrjetin shpërndarës, stacionet e pompimit, depot, rrugët hyrëse, furnizimin me energji elektrike dhe sistemet e komandimit e automatizimit. Kjo strukturë tregon se punimet duhet të zhvillohen në disa fronte dhe me grupe pune të specializuara.

Lidhja me volumin e punimeve të gërmimit dhe të dheut

Ndërtimi i rrjetit kërkon volume të konsiderueshme gërmimesh, transporti dhe mbushjesh, të cilat për nga natyra realizohen me kombinimin e mjeteve mekanike dhe fuqisë punëtore.

Vetëm në nënobjektin e rrugëve hyrëse parashikohen 326.9 m³ gërmim dheu, 473.6 m³ gërmim shkëmbi, 123.4 m³ gërmim shkëmbi me çekiç dhe 923.89 m³ mbushje e ngjeshje.

Në rrjetin shpërndarës evidentohen gjithashtu volume shumë më të mëdha të gërmimeve dhe mbushjeve, ndërsa vetëm shtresa e materialit mbushës/nënshtresës arrin në 4,557.1 m³, dhe shtresa e rërës në 2,962.5 m³.

Këto procese kërkojnë operatorë makinerish, drejtues mjetesh, punëtorë për nivelim, ngjeshje, sistemim të kanalit, sinjalistikë dhe mbështetje të vazhdueshme të grupeve të montimit.

Lidhja me gjatësinë e tubacioneve dhe punimet hidraulike

Pjesa dominuese e kontratës lidhet me instalimin e tubacioneve.

Linja kryesore e transmetimit përmban 6,095 ml tubacion PE Ø200 mm PN16, së bashku me ndërtimin e pusetave, rakorderitë, valvulat dhe pajisjet hidraulike. Për të gjithë këtë gjatësi parashikohen gjithashtu pastrimi, dezinfektimi dhe testimi i linjës.

Në rrjetin shpërndarës parashikohen tubacione me diametra të ndryshëm, ndër të tjera 136 ml Ø250 mm, 540 ml Ø200 mm, 493 ml Ø160 mm, 205 ml Ø125 mm dhe 1,966 ml Ø90 mm, përveç diametrave të tjerë.

Vetëm testimi dhe dezinfektimi i rrjetit shpërndarës kryhet në një gjatësi prej 12,231 ml, çka tregon përmasën reale të rrjetit që duhet të realizohet, kontrollohet dhe vihet në funksion.

Për realizimin e këtyre punimeve nevojiten në të njëjtën kohë ekipe për hapjen e kanalit, përgatitjen e shtratit të tubit, montimin dhe bashkimin e tubacioneve, montimin e rakorderive, mbushjen e kanalit, testimin, dezinfektimin dhe rikthimin e sipërfaqeve.

Lidhja me veprat e artit dhe pusetat

Preventivi përmban edhe volum të rëndësishëm punimesh betonarme dhe ndërtim pusetash.

Vetëm në një pjesë të rrjetit parashikohen: 1 pusetë betoni H = 4–5 m, 4.5 × 2.5 m; 33 puseta betoni 1.5 × 1.5 m, H = 5 m; 21 puseta të tjera me të njëjtat përmasa.

Linja e transmetimit përmban gjithashtu 40 puseta kryesore betoni 2 × 2 m me thellësi 2.5–3.5 m.

Këto punime kërkojnë betonues, hekurkthyes, karpentierë, muratorë, montatorë, punëtorë të përgjithshëm dhe staf teknik për kontrollin e kuotave dhe cilësisë së punimeve.

Lidhja me punimet rrugore dhe rikthimin e sipërfaqeve

Ndërtimi i tubacioneve realizohet në një masë të konsiderueshme në trase rrugore ekzistuese, ndaj krahas grupeve hidraulike duhen ekipe të veçanta për prishjen dhe rikthimin e rrugëve.

Vetëm rrjeti shpërndarës përmban rikthimin e 3,471.3 m² rrugëve të pashtuara dhe 2,718.7 m² rrugëve të asfaltuara, krahas trotuareve dhe sipërfaqeve të betonit.

Në linjën e transmetimit parashikohet gjithashtu prishja e 263 m³ shtresave të betonit, përveç punimeve të shtresave rrugore dhe asfaltimit.

Kjo natyrë e punimeve kërkon që ekipet e rrugës të funksionojnë paralelisht me ekipet e tubacionit, në mënyrë që segmentet e përfunduara të rikthehen në gjendjen e kërkuar pa bllokuar vazhdimin e traseve të tjera.

Lidhja me stacionet e pompimit dhe punimet ndërtimore

Kontrata përmban gjithashtu ndërtime civile dhe elektromekanike në stacionet e pompimit dhe depot.

Në STP1 parashikohen punime gjurmimi, betonarme dhe instalime teknologjike; ndër të tjera preventivi përmban beton për themele, trarë dhe breza, si dhe instalim pompe $Q = 5$ l/s, $H = 66$ m, $N = 11$ kW.

Në stacionin e pompave në Shirokë parashikohen edhe 2 pompa zhytëse Booster $Q = 20$ l/s, $H = 70$ m, së bashku me punime ndërtimore, rrethime, hidroizolime dhe instalime.

Për këto procese duhen grupe të tjera të specializuara: hidraulikë, montatorë, mekanikë, elektrikistë, saldatorë dhe punëtorë ndërtimi.

Krahas punimeve civile dhe hidraulike, kontrata përmban punime elektrike të tensionit të mesëm dhe automatizim.

Preventivi parashikon 11 shtylla për linjat 0.4–10 kV, shtrirjen dhe tërheqjen e përcjellësve për 1.62 km, izolime në linja 6–10 kV dhe sistem tokëzimi.

Gjithashtu parashikohet instalimi i transformatorit 10/20/0.4 kV, 180 kVA, pajisjeve TM dhe aksesoreve përkatës.

Nënobjekti i automatizimit përmban qindra dhe mijëra metra kablo kontrolli dhe fuqie, duke përfshirë 1,200 m kablo 4×1.5 mm², 600 m kablo 4×2.5 mm², 200 m kablo 4×4 mm², si dhe kablo të armuara dhe instalime të tjera.

Kjo do të thotë se krahas punëtorëve civilë duhet të ketë personel elektrik dhe elektromekanik që punon paralelisht në objekt.

Nëse punimet do të zhvilloheshin vetëm në një front linear, me përfundimin e plotë të çdo segmenti përpara nisjes së segmentit tjetër, realizimi i të gjithë volumit të mësipërm brenda 18 muajve do të vështirësohej ndjeshëm. Për këtë arsye, natyra e kontratës kërkon organizim në disa fronte pune paralelisht.

Në praktikën e zbatimit të preventivit mund të nevojiten në të njëjtën periudhë: grupe gjurmimi dhe transporti; grupe për shtratin dhe montimin e tubacioneve; grupe për rakorderi dhe instalime hidraulike; ekipe për pusetat dhe betonarmenë; ekipe për rikthimin e rrugëve dhe asfaltimin; ekipe për stacionet e pompimit dhe depot; ekipe elektrike dhe automatizimi; operatorë të mjeteve të rënda; staf teknik, topografik, sigurie dhe kontrolli të cilësisë.

Prandaj numri 80 punonjës nuk duhet parë sikur të gjithë punonjësit do të angazhohen në të njëjtin proces pune, por si kapaciteti minimal organizativ që i mundëson operatorit të krijojë disa ekipe njëkohësisht dhe të ruajë ritmin e nevojshëm për përfundimin e kontratës brenda 18 muajve.

Nëse ky numër shpërndahet përgjatë 18 muajve, ai përfaqëson potencialisht 1,440 punonjës-muaj kapacitet pune (80×18), pa nënkuptuar se të gjithë punonjësit duhet të jenë çdo ditë në të njëjtin kantier. Ky tregues ilustron vetëm shkallën e burimeve njerëzore që duhet të jetë në dispozicion për organizimin e një kontrate me këtë volum dhe shumëllojshmëri procesesh.

Lidhja me kërkesën për 3 muajt e fundit

Kërkesa që operatori të provojë se e ka pasur këtë nivel punësimi për 3 muajt e fundit përpara hapjes së tenderit shërben për të vërtetuar se kapaciteti njerëzor nuk është krijuar vetëm formalisht në momentin e ofertimit, por përfaqëson një strukturë ekzistuese dhe të qëndrueshme të operatorit. Vërtetimi i administratës tatimore dhe listëpagesat për 3 muajt e fundit krijojnë një bazë objektive për verifikimin e këtij kapaciteti dhe japin siguri se operatori disponon realisht burimet njerëzore të nevojshme për mobilizimin e kontratës.

Përfundim

Duke marrë në konsideratë:

volumin financiar të objektit, me nënobjekte të shumta dhe një vlerë të përgjithshme të konsiderueshme;

shtrirjen e rrjetit, ku vetëm linja e transmetimit është 6,095 ml dhe rrjeti shpërndarës ka mbi 12 km linja që i nënshtrohen testimit dhe dezinfektimit;

volumet e gjermimeve, mbushjeve, puseta, punimeve rrugore dhe betonarmeve;

bashkëekzistencën e punimeve hidraulike, civile, rrugore, mekanike, elektrike dhe automatizimit; si dhe afatin relativisht të kufizuar prej 18 muajsh,

kërkesa për disponimin e minimum 80 punonjësve lidhet me nevojën për kapacitet të mjaftueshëm njerëzor për organizimin e disa fronteve të punës njëkohësisht, ruajtjen e vazhdimësisë së proceseve dhe realizimin në kohë të kontratës.

Numri 80 duhet të konsiderohet si kapacitet minimal i përgjithshëm i operatorit, ku përfshihen stafi teknik, punonjësit e kualifikuar, operatorët e makinerive dhe fuqia punëtore mbështetëse, dhe jo si kërkesë që 80 persona të jenë domosdoshmërisht të pranishëm njëkohësisht në një front të vetëm pune.

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë personelin kryesor drejtues teknik të përbërë nga 2 inxhinierë hidroteknikë, 1 inxhinier ndërtimi, 1 inxhinier elektrik, 1 inxhinier gjeoteknik dhe 1 inxhinier gjeodet/topograf lidhet drejtpërdrejt me natyrën shumëdisiplinore të objektit dhe me proceset konkrete të parashikuara në preventiv.

Objekti përfshin jo vetëm ndërtimin e linjave të ujësjellësit, por edhe stacione pompimi, depo, punime betonarme, punime elektrike dhe automatizimi, gjermime në tokë e shkëmb, punime në kanale me prani uji dhe punime të shtrira në trase të gjata lineare. Fleta përmbledhëse e evidenton linjën e transmetimit, STP1, stacionin e pompave, depon e re 50 m³, rrjetin shpërndarës dhe furnizimin me energji elektrike e automatizimin.

Inxhinier Hidroteknik – 2 persona

Kërkesa për 2 inxhinierë hidroteknikë lidhet me faktin se pjesa dominante e objektit është sistem ujësjellësi dhe puna zhvillohet njëkohësisht në disa nënobjekte hidraulike.

Vetëm linja e transmetimit përfshin 6,095 ml tub PE Ø200 mm PN16, 40 puseta kryesore, rakorderi, testim, pastrim dhe dezinfektim të të gjithë linjës.

Rrjeti shpërndarës përfshin tubacione me diametra Ø250, Ø200, Ø160, Ø125, Ø90 dhe diametra të tjerë, ndërsa testimi dhe dezinfektimi i rrjetit shtrihet në 12,231 ml.

Për më tepër objekti përmban stacione pompimi dhe pajisje hidraulike, përfshirë pompa Booster me parametra Q=20 l/s, H=70 m, pompa për STP1 dhe stacion tjetër presioni.

Në këto kushte, dy inxhinierë hidroteknikë është vendosur nga nevoja për ndjekjen paralelisht të linjës kryesore, rrjetit shpërndarës, stacioneve të pompimit, depove, montimit të pajisjeve, testimeve hidraulike dhe vënies në funksion. Një inxhinier i vetëm do të duhej të mbulonte procese të shumta dhe fronte pune të largëta e të ndryshme teknikut.

Inxhinier Ndërtimi – 1 person

Inxhinieri i ndërtimit lidhet me të gjitha punimet civile, konstruktive dhe betonarme që shoqërojnë sistemin hidraulik.

Preventivi përfshin betonarme për plinta, kolona, trarë dhe soleta; vetëm në një nënobjekt parashikohen rreth 169.66 m³ trarë betonarme, 15.40 m³ soleta, si dhe sasi të konsiderueshme hekuri për beton.

Gjithashtu parashikohet ndërtimi i dhjetëra pushtave betonarme, ndërhyrje në STP1, depon e re 50 m³ dhe elemente të tjera strukturore. Për STP1 preventivi përfshin themele, trarë dhe breza betonarme.

Për rrjedhojë, inxhinieri i ndërtimit është i nevojshëm për kontrollin e punimeve të betonit dhe betonarmesë, armaturave, kallëpeve, dimensioneve konstruktive, pushtave, depove, bazamenteve dhe elementeve të stacioneve të pompimit.

Inxhinier Elektrik – 1 person

Inxhinieri elektrik lidhet drejtpërdrejt nga nënobjektet e furnizimit me energji elektrike dhe automatizimit.

Preventivi parashikon transformator 10/20/0.4 kV, 180 kVA, ndarës TM 20 kV, panele dhe instalime elektrike.

Gjithashtu përfshihen panele elektrike me PLC dhe inverterë, sensorë niveli e presioni dhe pajisje automatizimi për stacionet dhe depot.

Në nënobjektin e furnizimit me energji elektrike parashikohen edhe punime në nënstacion, tokëzim dhe punime elektrike të tensionit të mesëm.

Prandaj prania e inxhinierit elektrik është e nevojshme për kontrollin e instalimeve të fuqisë, linjave TM/TU, paneleve, mbrojtjeve, tokëzimit, lidhjes së pompave, sistemeve të kontrollit dhe koordinimit me sistemin hidraulik.

Inxhinier Gjeoteknik – 1 person

Kërkesa për inxhinier gjeoteknik lidhet me karakterin e gërmimeve dhe kushtet e terrenit.

Preventivi përmban gërmime në tokë të fortë, shkëmb, punime me prani uji dhe gërmime në thellësi të konsiderueshme. Në rrjetin shpërndarës parashikohen, ndër të tjera, 1,352.2 m³ gërmim në kanal me prani uji, 1,528.9 m³ gërmim me prani uji rreth 2 m, 538 m³ gërmim shkëmbi dhe 6,577.6 m³ gërmim shkëmbi mesatar me çekiç.

Veçanërisht domethënëse është kërkesa për mbrojtjen e kanalit me palankola për thellësi mbi 1.7 m deri në 6 m, në 8,126.3 m².

Në këto kushte, inxhinieri gjeoteknik lidhet me vlerësimin e qëndrueshmërisë së gjurmëve, sjelljes së tokës dhe shkëmbit, kontrollin e skarpave dhe mbrojtjes së kanaleve, si dhe masat teknike gjatë punëve në terrene me prani uji dhe në thellësi.

Inxhinier Gjeodet / Topograf – 1 person

Kërkesa për inxhinier gjeodet/topograf lidhet me vetë natyrën lineare dhe të shpërndarë të objektit.

Linja kryesore ka gjatësi 6,095 m, ndërsa rrjeti shpërndarës ka mbi 12 km linja që testohen dhe dezinfektohen.

Realizimi i këtyre linjave kërkon përcaktimin e vazhdueshëm të aksit të tubacionit, kuotave të gjurmës, niveleve të shtratit të tubit, pozicionimit të pusëve, depove, stacioneve të pompimit dhe rikthimit të rrugëve.

Preventivi nuk përmban një zë të veçantë të emërtuar “punime topografike”, ndaj lidhja e kësaj figure nuk del si vlerë financiare më vete. Megjithatë, nga vetë shtrirja lineare dhe numri i veprave rezulton se kontrolli topografik është funksion teknik i domosdoshëm gjatë zbatimit.

Kërkesa që Operatori Ekonomik të disponojë staf tjetër inxhinierik, konkretisht 1 Inxhinier Ndërtimi – profili Strukturist dhe 1 Inxhinier Mjedisi – profili Trajtim Uji, lidhet me dy grupe të dallueshme punimesh që rezultojnë nga preventivi: nga njëra anë, strukturat betonarme dhe veprat ndërtimore, dhe nga ana tjetër, infrastruktura e furnizimit, transportit, magazinimit dhe kontrollit të ujit.

Inxhinier Ndërtimi / Profili Strukturist – 1 person

Kërkesa për një inxhinier ndërtimi me profil strukturist lidhet drejtpërdrejt me praninë në preventiv të një numri të konsiderueshëm punimesh konstruktive, të cilat nuk kufizohen vetëm në punime ndihmëse të rrjetit.

Në preventiv parashikohen struktura betonarme për plinta, kolona, trarë dhe soleta. Konkretisht, evidentohen rreth 169.66 m³ struktura monolite betoni për trarë C20/25, rreth 15.40 m³ soleta, si dhe betonarme për plinta dhe kolona. Po në të njëjtin nënobjekt parashikohen mbi 10 ton hekur armature S500s, të shpërndarë në diametra të ndryshëm.

Në linjën e transmetimit parashikohet gjithashtu ndërtimi i 40 pusëve kryesore betonarme 2×2 m, me thellësi 2.5–3.5 m, me vlerë totale rreth 7.68 milionë lekë.

Në rrjetin shpërndarës evidentohen edhe puseta të tjera betonarme dhe punime të konsiderueshme të shtresave e betonit, ndërsa në nënobjektet e stacioneve dhe depove përfshihen themele, trarë, breza, mure, soleta dhe elemente të tjera mbajtëse. Për STP1, preventivi parashikon themele betoni, trarë dhe breza betonarme.

Po kështu, për depon e re 50 m³, shënimet e preventivit identifikojnë shprehimisht breza betonarme C30/37, soleta të plota betonarme dhe struktura monolite betoni për themele, çka tregon se bëhet fjalë për një vepër strukturore të mirëfilltë dhe jo vetëm për montim pajisjesh.

Për këtë arsye, inxhinieri strukturist lidhet me nevojën për kontrollin teknik të themeleve, plintave, kolonave, trarëve, soletave, mureve betonarme, pusëve dhe veprave të tjera mbajtëse, duke garantuar zbatimin korrekt të dimensioneve, armaturës, klasave të betonit dhe detajeve konstruktive të projektit.

Në raport me volumin, prania e strukturistit është e justifikuar sepse punimet konstruktive shtrihen në disa nënobjekte njëkohësisht: stacionet e pompimit, depot, pusetat e rrjetit dhe strukturat mbështetëse. Pra, kërkesa nuk mbështetet në një zë të vetëm të preventivit, por në një grup të gjerë dhe të përsëritur punimesh betonarme dhe strukturore.

Inxhinier Mjedisi – 1 person

Kërkesa për një inxhinier mjedisi lidhet me respektimin e kërkesave teknike dhe mjedisore gjatë proceseve të punës në përputhje me VNM, pasi kemi të bëjmë me nderhyrje në mjedis prishje, germime, ndertime dhe rikthim në gjendjen e mëparshme të mjedisit. Punimet do të kryhen përgjatë segmentit të rrugës Shkoder-Shirokë, brigjeve të liqenit të Shkodrës.

Gjithashtu ndërtimin dhe vënien në funksion të një sistemi furnizimi me ujë, ku kontrolli i cilësisë së ujit dhe procedurat e pastrimit e dezinfektimit janë pjesë e drejtpërdrejtë e preventivit.

Vetëm linja kryesore e transmetimit parashikon 6,095 ml tubacion PE Ø200 mm PN16 dhe, për të gjithë këtë gjatësi, preventivi përfshin pastrimin, dezinfektimin dhe testimin e linjës.

Rrjeti shpërndarës ka një shtrirje edhe më të madhe. Preventivi parashikon dezinfektim dhe testim për 12,231 ml linjë, së bashku me tubacione të diametrave të ndryshëm dhe një numër të madh rakorderish e kolektorësh.

Kjo do të thotë se kemi të paktën rreth 18.3 km linja ujësjellësi që, vetëm nga zërat e identifikuar, i nënshtrohen proceseve të kontrollit, testimit dhe dezinfektimit përpara vënies në përdorim.

Për më tepër, objekti përfshin: ndërtimin e depozitës së re 50 m³; ndërhyrje në depot ekzistuese; stacione pompimi; matje automatike të presionit; matje automatike të nivelit në 3 depo; sensorë niveli dhe presioni; sistem komandimi automatik të pompave.

Preventivi i automatizimit parashikon edhe 7 sensorë niveli hidrostatik dhe 4 sensorë presioni 16 bar, të cilët lidhen me monitorimin operacional të sistemit të ujësjellësit.

Për këtë arsye inxh. Mjedisi lidhet edhe me ndjekjen teknike të proceseve të pastrimit dhe dezinfektimit të tubacioneve, kontrollit të kushteve higjieno-sanitare të sistemit, vënies në funksion të depove dhe linjave, si dhe koordinimit të parametrave të funksionimit që lidhen me cilësinë e ujit.

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë staf teknik të specializuar dhe të certifikuar sipas profesioneve të përcaktuara është vendosur në përputhje me natyrën, kompleksitetin, volumet dhe shumëllojshmërinë e proceseve të punës të parashikuara në preventivin e objektit “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për zonën e Shirokës, Bashkia Shkodër”.

Objekti nuk konsiston vetëm në shtrimin e tubacioneve të ujësjellësit, por përfshin njëkohësisht: linjën e transmetimit, rrjetin shpërndarës, stacionet e pompimit, ndërtimin/rikonstruksionin e depove, punime elektrike dhe automatizimi, punime rrugore, germime dhe mbushje, punime betonarme, konstruksione metalike, muratura, suvatime, hidroizolime, bojatisje dhe rikthimin e sipërfaqeve të prekura nga punimet. Vetëm linja e transmetimit ka vlerë rreth 159.87 milionë lekë, ndërsa rrjeti shpërndarës rreth 123.09 milionë lekë.

Në linjën e transmetimit parashikohen ndër të tjera rreth 6,095 ml tubacion PE Ø200 mm PN16, ndërtimi i 40 pusetave kryesore prej betoni 2×2 m, rikthimi i 1,234 m² trotuareve me pllaka dhe 3,122 m² sipërfaqeve prej betoni, si dhe mbrojtja e kanalit me palankola në një sipërfaqe prej 8,126.3 m². Gjithashtu parashikohen pastrimi, dezinfektimi dhe testimi i 6,095 ml tubacion.

Rrjeti shpërndarës përmban tubacione PE me diametra të ndryshëm dhe volume të konsiderueshme, ndërsa vetëm në pjesën e rikthimit të sipërfaqeve parashikohen 776.3 m² trotuare me pllaka, 3,471.3 m² rrugë të pashtuara dhe 2,718.7 m² rrugë të asfaltuara. Në të njëjtin nënobjekt parashikohen 12,231 ml dezinfektim dhe testim linjash, çka evidenton shtrirjen e konsiderueshme lineare të kantierit.

Për rrjedhojë, numri dhe profilet e punonjësve të kërkuar lidhen drejtpërdrejt me proceset konkrete të preventivit, si më poshtë:

2 teknikë ndërtimi – kërkohen për ndjekjen operative të punimeve civile në disa fronte pune: gjurmime, mbushje, shtresa rrugore, puseta, struktura betonarme, rikthime sipërfaqesh dhe punime ndërtimore në stacionet e pompimit/depot. Shtrirja e objektit në disa nënobjekte dhe mundësia e zhvillimit paralel të proceseve justifikojnë disponimin e më shumë se një tekniku. Vetëm në linjën e transmetimit evidentohen volume të konsiderueshme gjurmimi, mbushjeje, transporti dhe shtresash, krahas punimeve të tubacionit.

1 teknik topograf – është i domosdoshëm për piketimin e aksit të tubacioneve, kuotave të gjurmimit, niveleve dhe pjerrësive, pozicionimin e pusetave dhe strukturave, si dhe kontrollin topografik gjatë realizimit. Nevoja lidhet veçanërisht me shtrirjen lineare të rrjetit: vetëm linja e transmetimit përmban 6,095 ml tubacion, ndërsa rrjeti shpërndarës përmban mbi 12 km linja që i nënshtrohen testimit.

1 teknik hidraulik dhe 5 hidraulikë – përbëjnë personelin bazë për montimin e rrjetit të ujësjellësit. Preventivi përmban mijëra metra tubacione PE me diametra të ndryshëm, rakorderi, manikota, adaptorë, fllanxha, saraçineska, valvula moskthimi dhe ajrues. Vetëm linja e transmetimit ka 6,095 ml tub PE Ø200 mm PN16. Në rrjetin shpërndarës evidentohen tubacione Ø250, Ø200, Ø160, Ø125 dhe Ø90 mm, krahas diametrave të tjerë. Kërkesa për 5 hidraulikë mundëson krijimin e grupeve të montimit dhe zhvillimit paralel të punimeve përgjatë traseve.

3 specialistë karpentierë – lidhen drejtpërdrejt me kallëpimin e strukturave betonarme, pusetave, stacioneve të pompimit, depove dhe elementeve të tjera konstruktive. Preventivi për stacionin e pompave parashikon betonarme për plinta, kolona, trarë dhe soleta; vetëm trarët përfaqësojnë rreth 169.66 m³ beton C20/25. Për këtë arsye kërkohet një grup pune prej 3 karpentierësh për realizimin dhe çmontimin e kallëpeve.

3 betonues –lidhen nga punimet e shumta të betonit dhe betonarmes në stacionet e pompimit, depot, pusetat dhe strukturat ndihmëse. Në nënobjektin e stacionit të pompave evidentohen mbi 200 m³ struktura betonarme vetëm nga zërat kryesorë të plintave, kolonave, trarëve dhe soletave. Krahas tyre, linja e transmetimit përmban 40 puseta kryesore betoni.

3 hekurkthyes – kërkohen për prerjen, përpunimin, kthimin dhe montimin e armaturës së strukturave betonarme. Vetëm në stacionin e pompave parashikohen rreth 10 ton armaturë S500s, me diametra nën dhe mbi 10 mm. Në nënobjekte të tjera preventivi përmban gjithashtu volume të konsiderueshme hekuri betoni, përfshirë 1.5 ton Ø6–10 mm dhe 7 ton Ø>12 mm në një nga strukturat.

2 pllakashtrues – lidhen me realizimin dhe rikthimin e trotuareve dhe sipërfaqeve me pllaka të prekura nga hapja e kanaleve. Vetëm linja e transmetimit përmban 1,234 m² rikthim trotuari me pllaka, ndërsa rrjeti shpërndarës edhe 776.3 m² të tjera. Kështu, kërkesa për 2 punonjës është proporcionale me një volum mbi 2,000 m² vetëm nga këta zëra.

2 asfaltoshtues – kërkohen për rikthimin e rrugëve të asfaltuara pas realizimit të tubacioneve. Në rrjetin shpërndarës parashikohet rikthimi i 2,718.7 m² rrugë të asfaltuara. Për më tepër, linja e transmetimit përmban shtresa binderi dhe asfaltobetoni me volume prej 8,184 m² secila, duke e bërë të argumentuar praninë e personelit të specializuar për asfaltim.

3 saldatorë – janë të nevojshëm për punimet me tubacione dhe pjesë speciale çeliku, fllanxha dhe konstruksione metalike. Preventivi parashikon 3.2 ton konstruksione metalike, pjesë speciale çeliku DN200 dhe DN100, fllanxha dhe elemente të tjera metalike. Numri 3 mundëson organizimin e punimeve të saldimit në fronte të ndryshme dhe përballimin e volumeve të montimit metalik.

2 elektrikistë –lidhen nga ekzistenca e një nënobjekti të posaçëm për furnizimin me energji elektrike, ku parashikohet vendosja e 11 shtyllave, shtrirja/tërheqja e 1.62 km përcjellësve, izolimi elektrik i linjës dhe realizimi i tokëzimit. Objekti përmban gjithashtu transformator, panele, kablllo dhe pajisje elektrike për funksionimin e sistemit të pompimit.

2 mekanikë – lidhen me montimin, kontrollin dhe mirëmbajtjen gjatë zbatimit të pajisjeve mekanike dhe elektromekanike të sistemit, përfshirë pompat, valvulat, saraçineskat, pajisjet e stacioneve të pompimit dhe makineritë e kantierit. Preventivi përfshin instalimin e pompave dhe pajisjeve të gatshme për punë, çka kërkon personel me profil mekanik për montim dhe asistencë teknike.

2 specialistë ndërtimi – kërkojnë për proceset e përgjithshme të ndërtimit që shoqërojnë realizimin e veprave, përfshirë riparimet, rikthimet e sipërfaqeve, punimet në depot dhe stacionet e pompimit dhe ndërhyrjet e ndryshme civile. Këta punonjës mbulojnë procese që nuk kufizohen në një zanat të vetëm dhe mundësojnë vazhdimësinë e punimeve ndërmjet grupeve të specializuara.

2 muratorë – lidhen nga zërat e muraturës në stacionet e pompimit dhe objektet ndihmëse. Preventivi përmban punime murature me tulla dhe murature guri, krahas punimeve të strukturave të ndërtesave. Këto procese kërkojnë personel të specializuar dhe nuk mund të konsiderohen pjesë e punimeve hidraulike.

2 suvatures – lidhen drejtpërdrejt me punimet e suvatimit të mureve, kolonave, trarëve dhe fasadave. Në një nga nënobjektet parashikohen, ndër të tjera, 462 m² suvatim në mure betoni, 41 m² suva solete dhe 150 m² suva fasade. Këto volume justifikojnë ekip të posaçëm prej 2 suvaturesish.

2 bojaxhinj – kërkojnë për bojatisjen e ambienteve dhe elementeve metalike. Preventivi përmban bojatisje hidroplastike, bojë vaji mbi sipërfaqe metalike dhe bojatisje të konstruksioneve metalike. Në linjën e transmetimit parashikohen 526 m² bojatisje mbi metal me minio dhe dy duar bojë vaji.

2 hidroizolues – lidhen me punimet e hidroizolimit të depove, stacioneve të pompimit, tarracave dhe tubacioneve. Në linjën e transmetimit parashikohet, ndër të tjera, izolimi i 863 m² tubacion, ndërsa nënobjektet ndërtimore përmbajnë hidroizolime me materiale bituminoze dhe me bazë çimentoje. Për rrjedhojë, kërkesa për dy punonjës të specializuar është e lidhur me procese konkrete të preventivit.

2 përgatitës të konstruksioneve metalike – kërkojnë për përgatitjen, prerjen, montimin dhe përshtatjen e profileve dhe elementeve metalike përpara dhe gjatë saldimet. Preventivi përmban 3.2 ton konstruksione metalike të thjeshta, pjesë speciale çeliku dhe një sërë konstruksionesh metalike të përbëra në nënobjektet e tjera. Ky profil është komplementar me saldatorët dhe nevojitet për organizimin e procesit të fabrikimit/montimit.

3 shoferë të pajisur me leje drejtimi të kategorisë “C” dhe CAP – kërkojnë për transportin e materialeve të gërmuara, materialeve të ndërtimit, aggregateve, tubacioneve dhe materialeve të tjera përgjatë një kantieri të shtrirë. Vetëm në linjën e transmetimit parashikohen 4,037 m³ transporte dheu në zëra të veçantë dhe 4,498 m³ transport materialeve ndërtimi/dheu deri në 10 km. Nevoja për mjete transporti dhe drejtues të kualifikuar është, për rrjedhojë, e lidhur drejtpërdrejt me volumet e preventivit. Gjithashtu, edhe në nënobjektin e stacionit të pompave parashikohet transport dheu me automjete.

Kërkesa që Operatori Ekonomik të disponojë të paktën 3 (tre) eskavatoristë, 2 (dy) automakinistë, të punësuar ose të kontraktuar me kontratë pune/shërbimi deri në përfundimin e kontratës, lidhet me natyrën dhe volumet e konsiderueshme të punimeve mekanike të parashikuara në preventiv, veçanërisht me punimet e gërmimit, transportit, mbushjes, nivelimit, shpërndarjes dhe sistemit të materialeve.

3 (tre) eskavatoristë – kërkesa lidhet drejtpërdrejt nga numri dhe volumet e zërave të preventivit që parashikojnë përdorimin e ekskavatorëve me goma dhe me zinxhir, si për gërmime dheu ashtu edhe për gërmime shkëmbore. Në nënobjektin e linjës së transmetimit parashikohen, ndër të tjera, 2,531.32 m³ gërmim dheu me ekskavator me goma dhe 6,004.68 m³ gërmim shkëmbi me çekiç me ekskavator me zinxhir.

Edhe në pjesë të tjera të objektit volumet janë të konsiderueshme. Preventivi parashikon, ndër të tjera, 1,352.2 m³ gërmim dheu me ekskavator me goma, 1,528.9 m³ gërmim me ekskavator me

zinxhir, 1,038.5 m³ gërmim me ekskavator me zinxhir, 538 m³ gërmim shkëmbi me ekskavator, 3,465.5 m³ gërmim dhe me ekskavator me goma, si dhe 6,577.6 m³ gërmim shkëmbi me çekiç me ekskavator me zinxhir.

Gjithashtu, në nënobjekte të tjera parashikohen gërmime me ekskavator në kushte dhe tipe terreni të ndryshme, përfshirë gërmime me prani uji dhe gërmime shkëmbore. Për këtë arsye, disponimi i 3 ekskavatoristëve konsiderohet proporcional, pasi mundëson përdorimin e mjeteve të ndryshme të gërmimit dhe zhvillimin e punimeve në më shumë se një front pune, pa krijuar ndërprerje në realizimin e traseve të rrjetit.

2 (dy) automakinistë – kërkesa lidhet me volumet e larta të transportit të materialeve të gërmuara dhe materialeve të ndërtimit. Në linjën e transmetimit parashikohen dy zëra të veçantë me nga 4,037 m³ transport dhe me automjet deri në 3 km, për depozitimin dhe ripërdorimin e materialit në mbushjen e kanalit. Në një tjetër pjesë të objektit parashikohet transporti i 6,919.6 m³ material ndërtimi/dhe deri në 10 km.

Në nënobjektin e stacionit të pompave parashikohet gjithashtu transporti i 1,147.5 m³ dhe me automjet deri në 2 km dhe 5 km. Për shkak të vazhdimësisë së procesit teknologjik gërmim – ngarkim – transport – depozitim/mbushje, disponimi i vetëm një drejtuesi mjeti do të kufizonte ndjeshëm ritmin e punimeve. Kërkesa për 2 automakinistë synon të sigurojë që transporti i materialeve të zhvillohet paralelisht me gërmimin dhe furnizimin e kantierit.

g) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar si staf mbështetës, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome (në rast se është inxhinier), dëshmi / certifikatë trajnimi të lëshuara nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së tenderit, punonjësit si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të certifikuar me dëshmi trajnimi si “Person i ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë” të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, kërkesë kjo në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Në rastin e bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, sipas nenit 88 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, secili prej operatorëve ekonomike duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1(një) “Person të ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë”, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkepunimit.
- 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, të pajisur me certifikatë të lëshuar nga Drejtoria e MZSH.
- 1 (një) inxhinier , i certifikuar si Specialist Për Testimin e Performances së Materialeve/Produkteve të Ndërtimit” lëshuar nga autoritetet të akredituara përgjegjëse shtetërore.

Shenim: Për specialistin “Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, Operatori Ekonomik mund ta disponojë edhe të kontraktuar me kontratë pune/shërbimi për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë Diplomë / Certifikatat e cituara më sipër.

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Agumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM Nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si **përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash** dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikqyrjes.

Në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar si kërkesë të kapacitetit teknik disponimin e personelit mbështetës të specializuar dhe të certifikuar, me qëllim garantimin e realizimit të kontratës në përputhje me projektin.

Kërkesa për disponimin e stafit mbështetës të specializuar në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, mbrojtjes nga zjarri dhe kontrollit të performancës së materialeve/produkteve të ndërtimit lidhet drejtpërdrejt me natyrën, kompleksitetin dhe rreziqet teknike të objektit, si dhe me shumëllojshmërinë e materialeve dhe proceseve të parashikuara në preventiv.

Objekti përfshin punime të konsiderueshme gërmimi në tokë dhe shkëmb, punime në prani uji, përdorim të makinerive të rënda, ndërtim strukturash betonarme, punime me konstruksione metalike, instalime hidraulike, punime elektrike të tensionit të mesëm, transformator, panele elektrike, pompa dhe pajisje elektromekanike. Për rrjedhojë, nevojitet personel i posaçëm për menaxhimin e sigurisë, rrezikut nga zjarri dhe kontrollin e cilësisë së materialeve.

1. Person përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë

Kërkesa për 1 (një) punonjës të certifikuar si “Person i ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë” lidhet nga karakteri kompleks dhe me risk i punimeve të objektit.

Preventivi parashikon punime gërmimi me ekskavator në kanale dhe themele, përfshirë gërmime në terrene shkëmbore dhe në prani uji. Në nënobjektin e STP1, për shembull, parashikohen gërmime shkëmbore me ekskavator në prani uji deri rreth 2 m dhe gërmime kanalesh me ekskavator me zinxhir në prani uji. Në rrugët hyrëse parashikohen gjithashtu gërmime dheu dhe shkëmbi me ekskavator dhe punime mekanike të mbushjes e ngjeshjes.

Veçanërisht domethënë është fakti që në linjën e transmetimit parashikohet mbrojtja e kanalit me palankola për thellësi mbi 1.7 m deri në 6 m, në një sipërfaqe prej rreth 8,126.3 m². Ky proces përfaqëson punim me rrezik të shtuar për shembje anësore të kanalit, rënie në gjërmim, punë në thellësi dhe ndërveprim të punonjësve me makineri të rënda.

Objekti përmban gjithashtu punime elektrike në linja 6–10 kV, vendosje të shtyllave, shtrirje dhe tërheqje përcjellësish dhe realizim të sistemit të tokëzimit. Po kështu, parashikohet instalimi i transformatorit 10/20/0.4 kV, paneleve elektrike dhe pajisjeve të tjera të tensionit të mesëm.

Pra, në të njëjtin objekt bashkëekzistojnë rreziqe nga, gjërmimet e thella dhe shembja e skarpateve; punimet në prani uji; lëvizja dhe puna e makinerive të rënda; transporti i materialeve; punimet e betonarmes dhe konstruksioneve metalike; punimet me saldim; punimet në lartësi dhe montimi i shtyllave; instalimet elektrike të tensionit të mesëm; pajisjet elektromekanike dhe stacionet e pompimit.

Për këtë arsye, prania e një personi të trajnuar dhe të certifikuar për sigurinë dhe shëndetin në punë është e lidhur drejtpërdrejt me nevojën për identifikimin e rreziqeve, zbatimin e masave parandaluese, kontrollin e përdorimit të pajisjeve mbrojtëse, organizimin e sigurisë në kantier dhe koordinimin e punimeve që zhvillohen paralelisht.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, kërkesa që secili anëtar të disponojë personin përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë është e arsyeshme në funksion të punimeve konkrete që secili prej tyre do të marrë përsipër sipas marrëveshjes së bashkëpunimit, pasi përgjegjësia për sigurinë duhet të garantohet në çdo front pune.

2. Specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit

Kërkesa për 1 (një) Specialist Ekspert Zjarrfikës lidhet kryesisht me praninë në objekt të punimeve elektrike, pajisjeve elektromekanike, transformatorit, paneleve elektrike, kabllave, konstruksioneve metalike dhe proceseve të saldimit.

Preventivi përfshin një nënobjekt të posaçëm për furnizimin me energji elektrike, me linjë 0.4–10 kV, 11 shtylla betonarme, rreth 1.62 km tërheqje përcjellësish dhe punime izolimi elektrik në linjë 6–10 kV.

Gjithashtu parashikohen panele elektrike të kompletuara me mbrojtje magnetotermike, PLC, inverter 22 kW, ngrohës, termostad dhe ventilator, si dhe sistem tokëzimi me përcjellës bakri dhe elektroda të zinkuara.

Me rëndësi të veçantë është instalimi i një transformatori me izolim me vaj 10/20/0.4 kV, 180 kVA, si dhe i ndarësit të tensionit të mesëm 20 kV, 400 A. Prania e transformatorit me vaj, pajisjeve elektrike të tensionit të mesëm dhe paneleve elektrike krijon nevojë të qartë për masa të posaçme të parandalimit dhe reagimit ndaj zjarrit.

Preventivi përmban gjithashtu konstruksione metalike dhe elemente çeliku. Në STP1 parashikohen konstruksione metalike të përbëra, fllanxha çeliku dhe instalime të pompave. Këto procese shoqërohen edhe me punime saldimi dhe punime të nxehta, të cilat paraqesin rrezik potencial për zjarr gjatë fazës së zbatimit.

Për rrjedhojë, specialisti ekspert zjarrfikës është i nevojshëm për vlerësimin dhe kontrollin e masave të mbrojtjes nga zjarri gjatë ekzekutimit të punimeve, veçanërisht në zonat ku realizohen: instalime elektrike; punime pranë transformatorit dhe paneleve; saldimet dhe prerjet metalike; montime elektromekanike; punime në stacionet e pompimit; magazinim ose përdorim materialeve potencialisht të djegshme.

Kërkesa lidhet, për rrjedhojë, me karakterin teknik të objektit dhe jo vetëm me ekzistencën formale të një kantieri ndërtimi.

3. Inxhinier i certifikuar si “Specialist për Testimin e Performancës së Materialeve/Produkteve të Ndërtimit”

Kërkesa për 1 (një) inxhinier, të certifikuar si Specialist për Testimin e Performancës së Materialeve/Produkteve të Ndërtimit varet nga shumëllojshmëria dhe volumet e konsiderueshme të materialeve dhe produkteve të ndërtimit që hyjnë në objekt dhe që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë, qëndrueshmërinë dhe sigurinë e veprës.

Preventivi përmban kategori të ndryshme betoni dhe betonarmeje. Në STP1 përdoren beton C16/20 dhe C20/25 për themele, trarë dhe breza betonarme. Në stacionin tjetër të pompave parashikohen plinta dhe kolona C25/30, si dhe trarë e soleta C20/25, me volume të konsiderueshme. Vetëm trarët përfaqësojnë rreth 169.66 m³ beton C20/25.

Preventivi përmban gjithashtu hekur armature të klasave dhe diametrave të ndryshëm, përfshirë armaturë S500s. Në rrjetin shpërndarës parashikohen shtresa rëre me volum rreth 2,962.5 m³, shtresa betoni C12/15 dhe nënshtresa me materiale të ndryshme.

Një komponent shumë i rëndësishëm janë tubacionet e ujësjellësit PE. Preventivi parashikon tuba me diametra të ndryshëm, përfshirë Ø250, Ø200, Ø160, Ø125 dhe Ø90 mm. Vetëm linja e transmetimit përmban 6,095 ml tubacion PE Ø200 mm PN16, ndërsa rrjeti shpërndarës ka mijëra metra tubacione të diametrave të ndryshëm dhe mbi 12 km linja që i nënshtrohen testimit.

Gjithashtu, preventivi përmban materiale dhe produkte të tjera si: çelik dhe konstruksione metalike; armaturë betoni; beton të klasave të ndryshme; rërë, zhavorr, stabilizant dhe çakëll; shtresa rrugore dhe asfaltike; materiale hidroizoluese; tuba dhe rakorderi; fllanxha, saraçineska, valvula dhe pajisje hidraulike; materiale dhe pajisje elektrike.

Për rrjedhojë, kontrolli i performancës dhe përputhshmërisë së materialeve nuk është një aktivitet periferik, por element thelbësor për sigurimin e cilësisë së objektit. Inxhinieri i certifikuar duhet të jetë në gjendje të ndjekë dokumentacionin teknik të materialeve, rezultatet e provave, karakteristikat e deklaruara dhe përputhjen e produkteve të përdorura me kërkesat e projektit dhe specifikimeve teknike.

Nevoja bëhet edhe më e evidentuar nga fakti se preventivi parashikon testimin e linjave të ujësjellësit, përfshirë 6,095 ml në linjën e transmetimit dhe 12,231 ml në rrjetin shpërndarës. Kjo tregon rëndësinë e kontrollit të performancës jo vetëm të materialeve të ndërtimit tradicional, por edhe të produkteve që bëhen pjesë funksionale e sistemit.

h) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërise ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi / me subjekte të specializuara për këtë qëllim. Mjekët të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit që plotëson kriteret e VKM Nr.742 datë 06.11.2003, duhet të plotësojë këtë kërkesë, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes se bashkëpunimit.

Argumentim: Kërkesa që Operatori Ekonomik të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë, ose të ketë të kontraktuar një mjek apo subjekt të specializuar për ofrimin e këtij shërbimi, lidhet me natyrën, kompleksitetin, shtrirjen dhe nivelin e ekspozimit të punonjësve ndaj rreziqeve profesionale gjatë realizimit të objektit.

Objekti “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për zonën e Shirokës, Bashkia Shkodër” përfshin një gamë të gjerë procesesh ndërtimore dhe teknologjike, të cilat zhvillohen në ambiente të hapura, në kanale, në terrene shkëmbore, në prani uji, pranë makinerive të rënda, si dhe në instalime elektrike

dhe elektromekanike. Për këtë arsye, kërkesa për sigurimin e mbështetjes mjekësore profesionale gjatë zbatimit të kontratës është e lidhur me karakteristikat konkrete të punimeve.

Preventivi parashikon punime të konsiderueshme gjurmimi me ekskavator, përfshirë gjurmime në tokë dhe shkëmb, punime në kanale dhe në prani uji. Vetëm në rrugët hyrëse parashikohen gjurmime dheu dhe shkëmbi me ekskavator, si dhe punime mekanike të mbushjes dhe ngjeshjes. Në nënobjektin e STP1 parashikohen gjithashtu gjurmime shkëmbore dhe gjurmime me ekskavator në kanale në prani uji.

Në linjën e transmetimit, natyra e punimeve paraqet risk të shtuar për punonjësit për shkak të hapjes së kanaleve dhe punimeve në thellësi, ku preventivi parashikon edhe mbrojtjen e kanalit me palankola për thellësi mbi 1.7 m deri në 6 m, në një sipërfaqe prej rreth 8,126.3 m². Këto procese krijojnë ekspozim ndaj rreziqeve si rrëshqitje apo shembje e skarpateve, rënie në kanale, goditje nga materiale ose makineri dhe ngarkesë të lartë fizike.

Gjithashtu, objekti përfshin punime me makineri të rënda, transport të materialeve, punime me beton dhe betonarme, hekur, konstruksione metalike, saldim, punime hidroizolimi dhe procese të tjera që kërkojnë angazhimin e një numri të konsiderueshëm punonjësish të profileve të ndryshme. Një komponent tjetër me rëndësi të veçantë është realizimi i punimeve elektrike të tensionit të mesëm. Preventivi parashikon linjë 0.4–10 kV, vendosjen e 11 shtyllave, shtrirjen dhe tërheqjen e rreth 1.62 km përcjellësish, si dhe punime izolimi elektrik në linja 6–10 kV dhe punime tokëzimi. Objekti përmban gjithashtu instalimin e transformatorit 10/20/0.4 kV, 180 kVA, pajisjeve të tensionit të mesëm, paneleve elektrike, pompave dhe pajisjeve elektromekanike. Këto procese shtojnë rrezikun potencial për dëmtime nga energjia elektrike, djegie, trauma mekanike ose incidente të tjera që kërkojnë organizim të përshtatshëm të mbikëqyrjes shëndetësore të punonjësve.

Përveç kësaj, preventivi përfshin punime në stacione pompimi dhe depo, konstruksione metalike, montim pompash dhe pajisjesh hidraulike. Në STP1, për shembull, parashikohen konstruksione metalike, montim tubacionesh dhe instalim pompe, çka evidenton ndërthurjen e proceseve ndërtimore, mekanike dhe elektromekanike.

Në këtë kontekst, mjeku i shoqërisë ose mjeku i kontraktuar ka funksion të rëndësishëm në lidhje me: ndjekjen e gjendjes shëndetësore të punonjësve në raport me natyrën e punës që kryejnë; vlerësimin e përshtatshmërisë shëndetësore për punë të caktuara me risk; mbështetjen për parandalimin e sëmundjeve dhe dëmtimeve profesionale; evidentimin e problematikave shëndetësore që mund të lidhen me ekspozimin në kantier; këshillimin për masat parandaluese dhe higjieno-sanitare; ndërhyrjen dhe orientimin profesional në rast të problematikave shëndetësore të lidhura me punën.

Kjo nevojë bëhet edhe më e argumentuar nga fakti se realizimi i objektivit kërkon një numër të konsiderueshëm punonjësish teknikë dhe të specializuar, si hidraulikë, saldatorë, betonues, hekurkthyes, karpentierë, elektrikistë, mekanikë, shoferë dhe operatorë të makinerive të rënda, të cilët ekspozohen ndaj llojeve të ndryshme të rrezikut profesional.

Lidhja me natyrën e objektivit

Në këtë objekt nuk kemi një proces të vetëm dhe të kufizuar ndërtimor, por një kantier të shtrirë dhe me disa fronte pune, ku ndërthuren: punime gjurmimi dhe kanalesh; punime në terren shkëmbor dhe në prani uji; transport dhe lëvizje me mjete të rënda; punime betonarme dhe metalike; montim tubacionesh dhe pajisjesh hidraulike; saldim dhe përpunim metali; punime elektrike të tensionit të mesëm; montim transformatori, panelesh dhe pompash; punime rrugore dhe rikthim sipërfaqesh.

Për këtë arsye, kërkesa për mbështetje mjekësore nuk është e shkëputur nga objekti i prokurimit, por lidhet me ruajtjen e aftësisë për punë dhe mbrojtjen e shëndetit të personelit që do të angazhohet në realizimin e këtyre proceseve.

- 2.3.4.** Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte” së bashku me aktin e miratimit dhe kodet 17 05 04 , 17 09 04, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo

nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Argumentim: Në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik të disponojë Licencë të kategorisë III.2.B për “Grumbullim, transportim, ruajtje/magazininim, rikuperim të mbetjeve të llojeve të ndryshme”, pasi kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe volumin e punimeve objekt kontrate.

Kërkesa që Operatori Ekonomik të jetë i pajisur me Licencë Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte”, së bashku me aktin e miratimit dhe kodet përkatëse të mbetjeve, lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punimeve të parashikuara në preventiv. Gjatë realizimit të objektit do të kryhen në shkallë të konsiderueshme gërmime dheu dhe shkëmbi, prishje të shtresave ekzistuese të betonit, ndërhyrje në rrugë të asfaltuara e të pashtuara, prishje trotuareve dhe veshjeve me pllaka guri, si dhe punime shpyllëzimi, procese nga të cilat krijohen materiale të dala nga gërmimi, prishja dhe pastrimi që duhet të grumbullohen, largohen dhe transportohen në mënyrë të kontrolluar.

Preventivi evidenton volume të konsiderueshme të gërmimeve. Në një nga nënobjektet parashikohen 3,465.5 m³ gërmim dheu, 538 m³ gërmim shkëmbi, 6,577.6 m³ gërmim shkëmbi me ekskavator me zinxhir, si dhe 6,919.6 m³ transport materialesh ndërtimi/dheu me automjet deri në 10 km. Vetë ekzistenca e zërit të transportit tregon se një pjesë e materialeve të gjeneruara nga proceset e ndërtimit duhet të largohet ose zhvendoset nga fronti i punimeve.

Në nënobjekte të tjera situata përsëritet. Për rrugët hyrëse parashikohen 326.9 m³ gërmim dheu, 473.6 m³ gërmim shkëmbi dhe 123.4 m³ gërmim shkëmbi me ekskavator, krahas punimeve të mbushjes. Në STP1 parashikohen gërmime shkëmbore dhe dheu, si dhe transport materialesh ndërtimi/dheu deri në 10 km.

Kërkesa bëhet edhe më e lidhur me objektin për shkak të punimeve të prishjes. Në preventiv është parashikuar shprehimisht zëri “Prishje shtresa betoni” në sasinë 263 m³ në një nënobjekt. Në rrjetin shpërndarës parashikohet gjithashtu prishja e 136 m³ shtresave të betonit. Këto procese prodhojnë materiale minerale të dala nga prishja, të cilat duhet të menaxhohen dhe transportohen sipas kërkesave përkatëse.

Po kështu, punimet e rrjetit shpërndarës ndërhyjnë drejtpërdrejt në infrastrukturën ekzistuese. Preventivi parashikon prerjen, prishjen dhe rikthimin e 3,471.3 m² rrugëve të pashtuara, 2,718.7 m² rrugëve të asfaltuara dhe 32.6 m² sipërfaqeve ekzistuese me pllakë guri. Nga këto procese krijohen materiale të dala nga shtresat rrugore, agregatet, betoni, gurët dhe materiale të tjera të ndërtimit.

Edhe punimet e shpyllëzimit dhe sistemimit të territorit gjenerojnë materiale që duhet të largohen nga kantieri. Vetëm në nënobjektin “Rrugët Hyrëse” parashikohet prerja dhe sistemimi i 221 pemëve me diametër 41–75 cm. Në STP1 parashikohet prerja dhe sistemimi i 40 pemëve Ø41–75 cm dhe 60 pemëve Ø21–40 cm.

Në raport me punimet e preventivit, kodet e kërkuara lidhen me kategoritë e mbetjeve që mund të krijohen gjatë zbatimit. Konkretisht, 17 05 04 lidhet drejtpërdrejt me dherat dhe materialet minerale të dala nga gërmimet, ndërsa 17 09 04 lidhet me mbetjet e përziera nga ndërtimi dhe

prishja. Këto dy kategori kanë lidhjen më të qartë dhe të drejtpërdrejtë me preventivin, duke pasur parasysh volumet e gërmimeve, prishjen e betonit dhe ndërhyrjet në rrugë e trotuare.

2.3.5. Makineri Pajisje

Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si me poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetedeklarimit):

Nr.	Përshkrimi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes jo me pak se 20 ton	2 (dy) copë
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 10 - 12 ton	2 (dy) copë
3	Kamionçina me kapacitet mbajtes deri në 3.5- 5 ton	2 (dy) copë
4	Autovinc me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton	3 (tre) copë
5	Rimorkiator për transportin e makinerive	1 (një) copë
6	Eskavator me zinxhire	2 (dy) copë
7	Minieskavator me zinxhire 5-10 ton	2 (dy) copë
8	Minieskavator me goma (mjet teknologjik me goma)	2 (dy) copë
9	Eskavator me goma (mjet teknologjik me goma)	2 (dy) copë
10	Minifadrome (mjet teknologjik me goma)	2 (dy) cope
11	Dumper kantieri 4-6 ton (mjet teknologjik me goma)	1 (nje) copë
12	Asfaltoshtruese	1 (një) copë
13	Autobitumatriçe e pajisur me certifikate transporti për mallra të rrezikshme	1 (një) copë
14	Freze asfalti	2 (dy) copë
15	Sharre asfalti / Betoni	3 (tre) copë
16	Rul ngjeshes hekur gome	1 (një) copë
17	Rul asfalti hekur hekur	1 (një) copë
18	Autobetoniere	1 (nje) copë
19	Autopompe betoni	1 (një) copë
20	Tokmak Elektrik	3 (tre) copë
21	Autobot uji	1 (një) copë
22	Matrapik	2 (dy) copë
23	Elektrosaldatrice	2 (dy) copë
24	Gjenerator	2 (dy) copë
25	Depozita uji	2 (dy) copë
26	Tranxhe hekuri/kthyesë hekuri	2 (dy) copë
27	Aparaturë për bashkim tubacionesh me metodën “Elektro Fusion”	2 (dy) copë

28	Aparature për bashkim tubacionesh me metodën “kokë më kokë”	2 (dy) copë
29	Total station	1 (një) copë
30	Gps	1 (një) copë
31	Aparat per testimin e presionit	2 (dy) copë
32	Palankola me thellesi deri 6m	20 ton
33	Agregate makineri vendosje/nxjerrese palankolash	1 (një) copë
34	Fabrike asfalti (e pajisur me leje mjedisore kodi III. 1 .B)	1(nje) copë
35	Fabrike Betoni, pajisur me leje mjedisore nga QKL	1(nje) copë

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”, si më poshtë vijon:

- Kokore + Jelekë fosforoshentë minimumi 50 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 10 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten e verifikimit te saktësisese informacionit. Mos dorëzimi i informacionit të saktë apo të rremë do te konsiderohet kusht për skualifikim.

Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

Për mjetet që shenohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronesine e mjetit (akti i pronësisë); leje qarkullimi; çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); siguracion mjeti (i vlefshëm).

Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: kontrata perkatëse e qerasë, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë), leje qarkullimi; çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracion mjeti (i vlefshëm).

Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor sidhe të dekalroj dhe vendndodhjen e mjeteve në pronesi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruar në këtë procedurë prokurimi nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 të ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik¹" në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore **e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Në nenin 39 "Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike" pika 6 /d të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 të ndryshuar parashikohet: "Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën."

Kërkesa për disponimin e mjeteve të mësipërme është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e konsiderueshme të gërmimeve dhe transporteve, furnizimin e vazhdueshëm të fronteve të punës me materiale, transportin dhe manipulimin e tubacioneve dhe pajisjeve, si dhe nevojën për zhvendosjen e makinerive të rënda ndërmjet nënobjekteve të ndryshme.

Objekti ka shtrirje të konsiderueshme dhe përfshin linjën e transmetimit, rrjetin shpërndarës, stacionet e pompimit dhe punime të tjera ndërtimore. Vetëm në linjën e transmetimit parashikohen 2,531.32 m³ gërmim dheu dhe 6,004.68 m³ gërmim shkëmbi, dy zëra transporti me automjet prej 4,037 m³ secili, si dhe 4,498 m³ transport materialesh ndërtimi/dheu deri në 10 km.

1. Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 20 ton – 2 copë

Kërkesa për 2 kamionë vetëshkarkues me kapacitet jo më pak se 20 ton lidhet drejtpërdrejt me volumet e larta të transportit të dheut, shkëmbit dhe materialeve të ndërtimit.

Në linjën e transmetimit preventivi përmban dy zëra të veçantë transporti me automjet, secili me volum 4,037 m³, si dhe 4,498 m³ transport materialesh ndërtimi dhe dheu deri në 10 km. Në nënobjektin e stacionit të pompave parashikohet gjithashtu transporti i 1,147.5 m³ dheu deri në 5 km.

Përdorimi i kamionëve me kapacitet të lartë është i nevojshëm për të përballuar ekonomisht dhe në kohë këto volume. Dy mjete mundësojnë organizimin e transportit në cikël, në mënyrë që ndërsa njëri mjet kryen shkarkimin ose është në transport, mjeti tjetër të jetë në proces ngarkimi, duke shmangur ndërprerjen e ekskavatorëve dhe të procesit të gërmimit.

2. Kamion vetëshkarkues me kapacitet 10–12 ton – 2 copë

Kërkesa për 2 kamionë vetëshkarkues 10–12 ton plotëson nevojën për transport në segmentet e objektit ku aksesueshmëria, gjerësia e rrugës ose hapësira e manovrimit nuk e bëjnë optimale përdorimin e mjeteve të tonazhit të madh.

Rrjeti shpërndarës zhvillohet përgjatë infrastrukturës ekzistuese dhe preventivi parashikon ndërhyrje në 3,471.3 m² rrugë të pashtruara, 2,718.7 m² rrugë të asfaltuara dhe sipërfaqe të tjera ekzistuese.

Për këto fronte pune nevojitet transport më fleksibël për largimin e materialeve nga gjurmimi dhe prishjet dhe për furnizimin me rërë, çakëll, stabilizant dhe materiale të tjera. Për këtë arsye kamionët 10–12 ton janë komplementarë me kamionët ≥20 ton dhe jo dublim i tyre.

3. Kamionçina me kapacitet mbajtës 3.5–5 ton – 2 copë

Kamionçinat kërkojnë për transportin e materialeve dhe pajisjeve me peshë më të vogël dhe për furnizimin e përditshëm të ekipeve të montimit përgjatë rrjetit.

Preventivi përmban mijëra metra tubacione dhe një numër të konsiderueshëm rakorderish, manikotash, adaptorësh, fllanxhash, saraçineskash dhe elementesh të tjerë. Në rrjetin shpërndarës përdoren tuba PE me diametra Ø250, Ø200, Ø160, Ø125, Ø90 dhe diametra të tjerë.

Gjithashtu, preventivi përmban një numër të madh kolektorësh dhe rakorderish EF për lidhjet e rrjetit.

Për këtë arsye, 2 kamionçina shërbejnë për furnizimin paralel të fronteve të ndryshme me materiale, pajisje dhe vegla, pa qenë e nevojshme të përdoren kamionët e mëdhenj për transporte të vogla.

4. Autovinc me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton – 3 copë

Kërkesa për autovinc lidhet me nevojën për ngarkim, shkarkim, ngritje dhe pozicionim të tubacioneve, pjesëve speciale, pajisjeve hidraulike, elementeve metalike dhe pajisjeve elektromekanike.

Vetëm linja e transmetimit përmban 6,095 m tubacion PE Ø200 mm PN16, si dhe 40 puseta kryesore betoni. Përveç tubacioneve, preventivi përmban manikota, adaptorë, fllanxa, saraçineska dhe pajisje të tjera që duhet të shkarkohen dhe pozicionohen përgjatë traseve.

Objekti përmban gjithashtu pajisje me peshë dhe përmasa që kërkojnë ngritje të mekanizuar, përfshirë pompa dhe transformator 10/20/0.4 kV, 180 kVA.

Për sa i përket sasisë prej 3 autovincash, kjo lidhet me shtrirjen e objektit dhe ndarjen e tij në disa fronte: një mjet mund të angazhohet në linjën e transmetimit, një në rrjetin shpërndarës dhe një në stacionet e pompimit/pajisjet elektromekanike. Në këtë mënyrë shmanget varësia e të gjitha fronteve nga një mjet i vetëm ngritës dhe sigurohet vazhdimësia e proceseve të montimit.

6. Rimorkiator për transportin e makinerive – 1 copë

Kërkesa për 1 rimorkiator për transportin e makinerive lidhet me domosdoshmërinë e mobilizimit dhe zhvendosjes së mjeteve teknologjike të rënda ndërmjet fronteve të ndryshme të objektit.

Preventivi parashikon në mënyrë të drejtpërdrejtë gjurmim me ekskavator me zinxhir, përfshirë vetëm në linjën e transmetimit 6,004.68 m³ gjurmim shkëmbi me çekiç me ekskavator me zinxhir. Gjurmim me ekskavator me zinxhir parashikohen edhe në nënobjekte të tjera. Për shembull, preventivi për punimet elektrike përmban 136.9 m³ gjurmim shkëmbi me ekskavator me zinxhir.

Makineritë me zinxhir dhe një pjesë e mjeteve teknologjike të kantierit nuk janë të përshtatshme për të kryer vetë lëvizje të gjata në rrugë publike. Për këtë arsye rimorkiatori është i nevojshëm për transportimin e tyre: nga baza në kantier; nga një nënobjekt në tjetrin; ndërmjet segmenteve të ndryshme të linjës; drejt dhe nga zonat e mirëmbajtjes.

Kërkesa për 1 rimorkiator konsiderohet e mjaftueshme, pasi ky mjet përdoret për mobilizimin periodik të makinerive dhe jo si pajisje që duhet të punojë vazhdimisht në çdo front.

7. Minieskavator me zinxhirë 5–10 ton 2 Preventivi përmban volume të konsiderueshme gjermimi në kanale dhe gjermimi shkëmbor me ekskavator me zinxhir. Vetëm në një pjesë parashikohen $6,004.68 \text{ m}^3$ gjermim shkëmbi me çekiç me ekskavator me zinxhir. Në një tjetër pjesë parashikohen $1,528.9 \text{ m}^3 + 1,038.5 \text{ m}^3$ gjermime me ekskavator me zinxhir, si dhe $6,577.6 \text{ m}^3$ gjermim shkëmbi me çekiç me ekskavator me zinxhir.
- 8 Minieskavator me goma 2 Preventivi ka në mënyrë të përsëritur gjermime me ekskavator me goma në kanale. Për linjën e transmetimit parashikohen $2,531.32 \text{ m}^3$ gjermim me ekskavator goma 0.25 m^3 . Në rrjetin tjetër evidentohen edhe $1,352.2 \text{ m}^3$ dhe $3,465.5 \text{ m}^3$ gjermime me ekskavator me goma.
- 9 Eskavator me goma 2 Vetë analizat e preventivit përcaktojnë përdorimin e ekskavatorëve me goma për gjermime në kanale. Përveç volumeve të mësipërme, edhe nënobjekti “Rrugët Hyrëse” përmban 326.9 m^3 gjermim me ekskavator goma dhe 473.6 m^3 gjermim shkëmbi me ekskavator 0.5 m^3 . Mjeti po; 2 copë duhen lidhur me frontet/afatin
- 10 Minifadromë 2 Preventivi kërkon jo vetëm gjermim, por edhe përhapje dhe ngjeshje me makineri të materialeve. Për linjën e transmetimit ka $1,673.6 \text{ m}^3$ mbushje me material të gjermuar, $7,365.6 \text{ m}^2$ shtresë çakëlli dhe $7,365.6 \text{ m}^2$ stabilizant. Në “Rrugët Hyrëse” ka gjithashtu 923.89 m^3 material të përhapur dhe ngjeshur me makineri.
- 11 Dumper kantieri 4–6 ton 1 Punimet krijojnë nevojë të vazhdueshme për lëvizjen e materialit të gjermuar dhe materialeve të mbushjes. Preventivi parashikon, ndër të tjera, $4,037 \text{ m}^3$ transport materiali për mbushjen e kanalit, përsëri $4,037 \text{ m}^3$ transport për mbushje, si dhe $4,498 \text{ m}^3$ transport materialesh/dheu deri 10 km.
- 12 Asfaltoshtuese 1 Kërkesa lidhet drejtpërdrejt me rikthimin e shtresave rrugore. Preventivi parashikon $8,184 \text{ m}^2$ shtresë binderi 6 cm me makineri dhe $8,184 \text{ m}^2$ shtresë asfaltobeton 4 cm me makineri. Këto janë zëra tipikë që kërkojnë mekanizim të specializuar për shtrimin e asfaltit.
- 13 Autobitumatriçe me certifikatë transporti për mallra të rrezikshme 1 Preventivi përmban shprehimisht “Spërkatje me emulsion bituminoz 1 l/m²” në $7,365.6 \text{ m}^2$. Prandaj një mjet për furnizimin/shpërndarjen uniforme të materialit bituminoz lidhet drejtpërdrejt me procesin teknologjik. Mjeti i argumentueshëm; certifikata specifike duhet justifikuar veçmas me natyrën/klasifikimin e materialit që transportohet
- 14 Frezë asfalti 2 Preventivi ka një zë të posaçëm “Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri”, $11,214 \text{ ml}$ prerje asfalti me disk. Kjo provon qartë ekzistencën e një volumi të konsiderueshëm të ndërhyrjeve në asfaltin ekzistues.
15. Sharrë asfalti / betoni 3 copë Preventivi parashikon në mënyrë të drejtpërdrejtë $11,214 \text{ ml}$ prerje asfalti me disk, në të dy anët, si dhe ndërhyrje në rrugë të asfaltuara dhe prishje shtresash betoni. Gjithashtu, për rrjetin shpërndarës parashikohet prerja, prishja dhe rikthimi në gjendjen fillestare i $2,718.7 \text{ m}^2$ rrugëve të asfaltuara. Për shkak të gjatësisë së konsiderueshme të traseve dhe mundësisë së zhvillimit të punimeve në disa fronte, kërkesa për 3 sharra lidhen me realizimin paralel të prerjeve përgjatë kanaleve.
- 16 Rul ngjeshës hekur-gomë 1 copë Objekti përmban volume të mëdha mbushjesh dhe shtresash rrugore që duhet të përhapen dhe ngjeshen mekanikisht. Vetëm në një nënobjekt parashikohen $1,673.6 \text{ m}^3$ mbushje, $7,365.6 \text{ m}^2$ shtresë çakëlli dhe $7,365.6 \text{ m}^2$ stabilizant. Ruli hekur-gomë është i lidhur me realizimin e ngjeshjes së njëtrajtshme të shtresave granulare dhe përgatitjen e bazës rrugore para shtresave bituminoze.
- 17 Rul asfalti hekur-hekur 1 copë Preventivi parashikon $8,184 \text{ m}^2$ shtresë binderi 6 cm me makineri dhe $8,184 \text{ m}^2$ asfaltobeton 4 cm me makineri. Për këtë proces është i nevojshëm rul

asfaltues me tambure metalike, për ngjeshjen dhe përfundimin e shtresave bituminoze sipas procesit teknologjik. Kërkesa për 1 copë është drejtpërdrejt e lidhur me këtë fazë të punimeve.

18 Autobetoniere 1 copë Preventivi përmban punime të shumta betoni dhe betonarmeje në depo, stacione pompimi, puseta dhe struktura të tjera. Për depon e re parashikohen struktura monolite C30/37 prej 37 m³, 11 m³ dhe 20 m³, krahas shtresave C12/15 dhe C16/20. Autobetonierja është e nevojshme për transportin e betonit të freskët drejt fronteve të punës, duke garantuar vazhdimësinë e betonimit dhe ruajtjen e karakteristikave të përzierjes.

19 Autopompë betoni 1 copë Punimet përfshijnë struktura monolite betonarmeje, mure, themele, soleta, trarë dhe elementë të stacioneve/depozitave. Preventivi identifikon shprehimisht breza/mure b/a, soleta të plota b/a dhe themele monolite C30/37. Autopompa kerkohet nga nevoja për vendosjen e betonit në elemente strukturore dhe zona ku shkarkimi direkt nga autobetonierja nuk është praktik ose teknikisht i përshtatshëm.

20 Tokmak elektrik 3 copë Ky mjet del shprehimisht në preventiv. Për linjën e transmetimit parashikohen 8,936 m³ “mbushje, rafshim, ngjeshje me tokmak elektrik, çdo 30 cm”. Në rrjetin shpërndarës parashikohen edhe 12,000 m³ me të njëjtin proces teknologjik. Për shkak të volumit shumë të madh dhe punimeve në kanale të gjata, 3 copë lidhet me zhvillimin paralel të disa fronteve të mbushjes dhe ngjeshjes.

21 Autobot uji 1 copë Natyra e punimeve përfshin gërmime, mbushje, shtresa çakëlli, stabilizant dhe rehabilitim rrugor në sipërfaqe të konsiderueshme. Autobot-i i ujit është funksionalisht i nevojshëm për lagështimin e materialeve gjatë procesit të ngjeshjes, kontrollin e pluhurit në kantier dhe mirëmbajtjen e kushteve të punës gjatë realizimit të shtresave. Preventivi nuk e përmend shprehimisht “autobot uji”, ndaj ky është argumentim nga procesi teknologjik dhe natyra e punimeve, jo nga një zë nominal i preventivit.

22 Matrapik 2 copë Objekti ka punime të konsiderueshme prishjeje në beton dhe ndërhyrje në sipërfaqe ekzistuese. Në linjën e transmetimit parashikohen 263 m³ prishje shtresa betoni, ndërsa në rrjetin shpërndarës rezultojnë edhe 136 m³ prishje shtresa betoni. Për këto ndërhyrje, matrapiku është mjet i përshtatshëm për prishje lokale, beton, bordura dhe zona ku makineritë e rënda nuk mund të operojnë.

23. Elektrosaldatrice 2 copë Preventivi përmban punime të konsiderueshme metalike: 3.2 ton konstruksione metalike të thjeshta, pjesë speciale çeliku DN200 me masë 7.546 ton, pjesë çeliku DN100, flanaxha çeliku dhe elemente të tjera metalike. Në nënobjekte të tjera parashikohen gjithashtu konstruksione metalike të përbëra dhe tuba çeliku. Për realizimin, përshtatjen dhe montimin në kantier të këtyre elementeve, elektrosaldatricja lidhet drejtpërdrejt me procesin e punës. Dy copë lidhen me zhvillimin e punimeve në fronte të ndryshme të linjës dhe objekteve teknologjike.

24 Gjenerator 2 copë Preventivi përfshin punime mekanike, saldime, montim tubacionesh dhe pajisjesh, si dhe punime përgjatë një traseje të shtrirë ku furnizimi i përhershëm elektrik nuk rezulton i garantuar nga vetë preventivi. Për shembull, parashikohen konstruksione metalike dhe montime teknologjike në disa nënobjekte. Dy copë lidhen me dy fronte pune të njëkohshme.

25 Depozita uji 2 copë Preventivi përmban gërmime, mbushje, punime betoni, pastrim, testim dhe dezinfektim tubacionesh. Vetëm linja kryesore përmban 6,095 ml tubacion PE DN200, si dhe zëra për pastrim, dezinfektim dhe testim të 6,095 ml linjë. Depozitat e ujit nuk emërtohen si pajisje në preventiv, por mund të lidhen me furnizimin e përkohshëm me ujë për proceset teknologjike dhe kantierin.

26 Tranxhe hekuri / kthyese hekuri 2 copë Kjo pajisje mbështetet fort nga preventivi. Vetëm për stacionin e pompave parashikohen 1.7355 t + 0.715 t hekur Ø<10 mm dhe 6.078 t + 1.495 t hekur Ø>10 mm S500s. Për depon e re parashikohen edhe 1.5 ton hekur Ø6–10 mm dhe 7

ton hekur $\varnothing > 12$ mm. Përpunimi i këtyre sasive kërkon prerje dhe kthim të shufrave sipas detajeve të armaturës.

27 Aparaturë për bashkim tubacionesh me metodën “Electro Fusion” 2 copë Kjo është ndër kërkesat më të forta. Preventivi parashikon shprehimisht manikota E.F. Dj-200 mm, përkatësisht 21 copë dhe 13 copë. Shkurtesa E.F. në këto zëra lidhet drejtpërdrejt me bashkimet elektro-fusion. Për më tepër, linja kryesore përmban 6,095 ml tub PE DN200 PN16. Prandaj aparatura Electro Fusion është drejtpërdrejt e lidhur me realizimin e bashkimeve të parashikuara.

28 Aparaturë për bashkim tubacionesh me metodën “kokë më kokë” 2 copë Preventivi përmban sasi shumë të mëdha tubacionesh PE në diametra të ndryshëm. Vetëm rrjeti shpërndarës ka 136 ml DN250, 540 ml DN200, 493 ml DN160, 205 ml DN125 dhe 1,966 ml DN90 në pjesën e cituar të preventivit. Krahas kësaj, linja e transmetimit ka 6,095 ml PE DN200 PN16. Preventivi nuk shkruan shprehimisht “kokë më kokë”, por volumi dhe diametrat e tubacioneve PE e bëjnë pajisjen teknikisht të lidhur me procesin e montimit.

29 Total Station 1 copë Preventivi tregon një objekt linear me mijëra metra tubacione, kanale, puseta dhe objekte të veçanta. Vetëm linja e transmetimit përmban 6,095 ml tubacion dhe 30 puseta kryesore betoni 2×2 m. Rrjeti shpërndarës përfshin gjithashtu tubacione në disa diametra dhe gjatësi të mëdha. Total Station është i lidhur me piketimin dhe kontrollin planimetrik/altimetrik të traseve dhe veprave.

31 GPS 1 copë Për të njëjtat arsye, GPS mund të lidhet me përcaktimin dhe kontrollin e koordinatave të rrjetit të ujësjellësit, puseve, nyjeve dhe objekteve teknologjike. Shtrirja është e konsiderueshme: vetëm një linjë është 6,095 ml, ndërsa rrjeti shpërndarës përmban mijëra metra të tjerë tubacionesh PE.

32. Aparat për testimin e presionit 2 copë Preventivi parashikon shprehimisht “Testim linjash” për 6,095 ml tubacion, krahas pastrimit dhe dezinfektimit të së njëjtës gjatësi. Duke qenë se bëhet fjalë për një rrjet ujësjellësi me tub PE DN200 PN16 dhe me shtrirje të konsiderueshme, pajisja për provën hidraulike të presionit është drejtpërdrejt e lidhur me zërin e preventivit. Dy copë mund të justifikohen me testimin e seksioneve të ndryshme ose të fronteve paralele të punës.

33 Palankola me thellësi deri 6 m 20 ton Preventivi përmban në mënyrë eksplicite zërin “Mbrotja e Kanalit me Palankola për thellësi > 1.7 m deri 6 m”, me sipërfaqe $8,126.3 \text{ m}^2$ në linjën e transmetimit. Në një tjetër pjesë të rrjetit parashikohet i njëjti proces për $4,795.6$ njësi sipas preventivit. Pra nevoja për palankola është drejtpërdrejt dhe shumë fort e provuar. Megjithatë, preventivi nuk jep vetë peshën 20 ton; ky tonazh duhet argumentuar me dimensionimin e sistemit të mbrojtjes, tipin e profileve dhe ciklin e ripërdorimit të palankolave.

34 Agregat/makineri për vendosje dhe nxjerrje palankolash 1 copë Përderisa preventivi përmban një volum shumë të madh pune me palankola deri në 6 m thellësi, përdorimi i një makinerie të specializuar për instalimin dhe nxjerrjen e tyre është pjesë funksionale e të njëjtit proces.

35 Fabrikë asfalti 1 copë Preventivi përmban një volum të rëndësishëm punimesh asfaltike: $8,184 \text{ m}^2$ shtresë binderi 6 cm dhe $8,184 \text{ m}^2$ asfaltobeton 4 cm, të dyja “me makineri”. Përveç tyre, parashikohen skarifikim i asfaltit ekzistues, $11,214 \text{ ml}$ prerje asfalti dhe $7,365.6 \text{ m}^2$ spërkatje me emulsion bituminoz. Këto volume e justifikojnë nevojën për një burim të sigurt prodhimi të përzierjeve asfaltike. Por preventivi nuk kërkon vetë që operatori të zotërojë fabrikë asfalti, dhe as nuk përmend lejen mjedisore me kodin III.1.B; këto janë kërkesa të veçanta që duhet të justifikohen nga mënyra e furnizimit dhe kuadri mjedisor.

36 Fabrikë betoni 1 copë Preventivi përmban punime të shumta betoni dhe betonarmeje në disa nënobjekte. Për depon e re, vetëm tre zëra C30/37 janë $37 \text{ m}^3 + 11 \text{ m}^3 + 20 \text{ m}^3$, krahas shtresave C12/15 dhe C16/20. Në STP parashikohen gjithashtu beton C20/25, struktura monolite

C25/30 dhe beton C12/15. Këto volume tregojnë nevojë të vazhdueshme për furnizim me beton të klasave të ndryshme.

2.3.6. Afati i kryerjes së punimeve

Afati i kryerjes së punimeve është 18 (tetembedhjete) muaj sipas Grafikut të Punimeve të publikuar ne SPE

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

2.3.7 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë deklaratën ku të shprehet se është dakort me menyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të perfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, (Në rast të shpalljes fitues).

Në funksion të plotësimit të Shtojcës Nr. 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emër, Mbiemër, Atësi, Amësi, Datëlindje, Vendlindje, Numër Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin / Administratorët e shoqërise, Ortakun / Ortakët e shoqërise, përfaqësues të ndryshëm të posacëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.

Bazuar në parashikimet e Rregullat e Prokurimit Publik, miratuar me VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku në pikën 6 të nenit 26 parashikohet: *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin;*

Si dhe sipas Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 neni 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, Pika 5 ku parashikohet: *“Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë:*

- a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;*
- b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.*

Ofertuesi i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin e parashikuar në pikën 6 të nenit 26 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, brenda afatit 5 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1 të LPP-së.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s`kualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike: Bazuar në specifikimet teknike dërguar nga shoqëria projektuese dhe përcjelle për punimet e vepres, duke qenë se specifikimet teknike të përcjella, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të Ligjit Nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 40 pika 2 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, njësia e prokurimit po publikon specifikimet teknike.

Njesia e Prokurimit